



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 174

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 14 tetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 98/2024, datë 12.9.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar..... 20099
Dekret i Presidentit nr. 353, datë 9.10.2024	Për shpallje ligji..... 20108
Ligj nr. 103/2024, datë 19.9.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”..... 20108
Dekret i Presidentit nr. 354, datë 9.10.2024	Për shpallje ligji..... 20110
Ligj nr. 104/2024, datë 19.9.2024	Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre..... 20111
Dekret i Presidentit nr. 355, datë 10.10.2024	Për shpallje ligji..... 20141
Ligj nr. 105/2024, datë 19.9.2024	Për disa ndryshime në ligjin nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”..... 20141
Dekret i Presidentit nr. 356, datë 10.10.2024	Për shpallje ligji..... 20142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 10.10.2024	Për përcaktimin e kushteve për mbajtjen e armës në përdorim personal, edhe jashtë orëve të shërbimit, nga punonjësi i Policisë së Burgjeve..... 20142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 440, datë 19.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor”..... 20143

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar.....	20144
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.....	20145
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 10.10.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 466, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”.....	20146
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 10.10.2024	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre”, të ndryshuar.....	20147
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e projektit ‘Ekipet sportive në shkolla’, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)”, të ndryshuar.....	20148
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”.....	20149



LIGJ
Nr. 98/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 64/2012 “PËR
PESHKIMIN”, I NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. “Anije mbështetëse” nënkupton një anije të ndryshme nga një mjet lundrues i mbajtur në bord, e cila nuk është e pajisur me vegla peshkimi të gatshme për t’u përdorur, e projektuar për të zënë ose për të tërhequr peshq dhe që përdoret për të lehtësuar, ndihmuar ose përgatitur operacionet e peshkimit.”.

2. Pikat 22/1 dhe 22/2 ndryshohen si më poshtë:

“22/1. “Infrastruktura e peshkimit” janë portet, qendrat e peshkimit, vendzbatimet dhe tërësia e trojeve, kalatave, godinave, përfshirë muret rrethuese të porteve dhe akuatoriumin, instalimet e sinjalizimit, të ndriçimit dhe të komunikimit.

22/2. Infrastruktura që lidhet me peshkimin përfshin: markatat, tregun e shitjes me shumicë,

linjat teknologjike, asetet e lidhura, shkallët e riparimit të anijeve të peshkimit, depozitat e karburantit, pasuritë e luajtshme dhe çdo pasuri ose objekt tjetër që i shërben peshkimit, pavarësisht nga emërtesa në inventar.”.

3. Pas pikës 38 shtohet pika 38/1 me këtë përmbajtje:

“38/1. Masat e ruajtjes dhe menaxhimit” janë masat e miratuara në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare për të ruajtur dhe menaxhuar një ose më shumë lloje të burimeve të gjalla ujore.”.

4. Pas pikës 41 shtohet pika 41/1 me këtë përmbajtje:

“41/1. “Markatë ose treg shitjeje me shumicë” është një treg, qendër ankandi ose strukturë tjetër e përhershme ose e përkohshme, e cila përdoret për tregtimin me shumicë të produkteve të peshkut.”.

5. Pas pikës 57 shtohen pikat 57/1 dhe 57/2 me këtë përmbajtje:

“57/1. “Pendë peshkaqeni” është çdo pendë peshkaqeni, përfshirë këtu edhe pendën kaudale, por duke përfshirë pendët pektorale të rajave, të cilat janë pjesë përbërëse e rajave.

57/2. “Peshkaqeni” është çdo peshk që bën pjesë në klasën *Elasmobranchii*.”.

6. Pikat 62 dhe 63 ndryshohen si më poshtë:

“62. “Peshkim tregtar profesional” është ajo kategori e peshkimit detar që ushtrohet nga anije me gjatësi më të madhe se 12 metra dhe me fuqi motorike të barabartë dhe/ose më të madhe se 56 KW ose 75 HP, ku përdoren rrjeta me tërheqje fundore ose pelagjike, veçmas ose së bashku, rrjeta me rrethim, draga hidraulike dhe linjë grepash ose pallangare.

63. “Peshkim tregtar artizanal ose peshkim bregdetar artizanal” është peshkimi tregtar që zhvillohet nga mjetet lundruese që përdorin çdo lloj vegle tjetër peshkimi, të ndryshme nga ato që përdoren në peshkimin tregtar profesional.”.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) 2017/2403 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2017 “Mbi menaxhimin e qëndrueshëm të flotës së jashtme të peshkimit” dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KE) nr. 1006/2008, Numri CELEX 32017R2403, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 347, datë 28.12.2017, f. 81–104.

- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1185/2003 të datës 26 qershor 2003 “Mbi heqjen e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijeve”, e ndryshuar. Numri CELEX 32003R1185, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L, 167, datë 4.7.2003, f. 1–3.

- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009 “Për krijimin e një sistemi kontrolli të Komunitetit për të garantuar përputhjen me rregullat e politikës së përbashkët të peshkimit”, duke ndryshuar Rregulloret (KE) nr. 847/96, (KE) nr. 2371/2002, (KE) nr. 676/2007, (KE) nr. 1098/2007, (KE) nr. 1300/2008, (KE) nr. 1342/2008 dhe shfuqizimin e Rregulloreve (KEE) nr. 2847/93, (KE) nr. 1627/94 dhe (KE) nr. 1966/2006. Numri CELEX 32009R1224, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L, 343, datë 22.12.2009, f. 1–50.”



7. Pas pikës 70 shtohet pika 70/1 me këtë përmbajtje:

“70/1. “Popullata ndërzonale” janë popullata peshqish që gjenden brenda Zonës Ekskluzive Ekonomike ose të një zone ngjitur me të.”.

8. Pika 108 ndryshohet si më poshtë:

“108. “Zonë e kufizuar e peshkimit” është një zonë detare specifike e përcaktuar gjeografikisht brenda një ose më shumë baseneve detare, ku të gjitha ose disa aktivitete peshkimi janë të kufizuara ose të ndaluara përkohësisht ose përgjithmonë, me qëllim përmirësimin e ruajtjes së burimeve biologjike të gjalla ose mbrojtjen e ekosistemeve detare, sipas përcaktimeve të legjislacionit të peshkimit, dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit për trashëgiminë kulturore.”.

9. Pika 110 ndryshohet si më poshtë:

“110. “Zonë e mbrojtur peshkimi” është një zonë ku nuk lejohet asnjë lloj aktiviteti peshkimi.”.

Neni 2

Kudo në ligj togfjalëshi “zonë e mbrojtur” zëvendësohet me togfjalëshin “zonë e kufizuar”, me përjashtim të nenit 12 dhe pikës 110 të nenit 4, dhe fjalët “inspektorati/inspektoratit/inspektoratin që mbulon fushën e inspektimit” zëvendësohen me fjalët “inspektorati/inspektoratit/inspektoratin që mbulon fushën e peshkimit”.

Neni 3

Neni 5 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Politikat e peshkimit

1. Politikat e peshkimit në Republikën e Shqipërisë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit.

2. Objektivat e politikës së peshkimit kanë për qëllim:

a) sigurimin që aktivitetet e peshkimit të jenë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore në periudhë afatgjatë dhe menaxhimin në përputhje me

objektivat e arritjes së përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, si dhe për të kontribuar në disponueshmërinë e furnizimeve ushqimore;

b) qasjen e kujdesshme të menaxhimit të peshkimit që synon të sigurojë që shfrytëzimi i burimeve të gjalla biologjike detare të rindërtojë dhe të mbajë popullatat e specieve të peshkuara mbi nivele të afta për të prodhuar rendimentin maksimal të qëndrueshëm;

c) zbatimin e qasjes së bazuar në ekosistemin për menaxhimin e peshkimit për të siguruar që aktivitetet e peshkimit të kenë një ndikim minimal në ekosistemet detare dhe që siguron që aktivitetet e peshkimit të shmangin degradimin e mjedisit detar;

ç) grumbullimin e të dhënave shkencore;

d) në mënyrë të veçantë:

i. të eliminojnë gradualisht hedhurinat bazuar në këshillat më të mira shkencore të disponueshme, duke shmangur e reduktuar, për aq sa është e mundur, zëniet aksidentale dhe duke siguruar në mënyrë progresive që ato të zbarkohen;

ii. kur është e nevojshme, të bëjnë përdorimin më të mirë të mundshëm të zënieve, jo objekt peshkimi, pa krijuar një treg për këto zënie, të cilat janë nën madhësinë minimale të referencës;

iii. të krijojnë kushtet e nevojshme për ta bërë sektorin e peshkimit e të përpunimit dhe aktivitetet në tokë që lidhen me peshkimin, ekonomikisht të qëndrueshme dhe konkurruese;

iv. të parashikojnë masa për të përshtatur kapacitetin e peshkimit të flotës me nivelet e mundësive të peshkimit, në mënyrë që të ketë një flotë ekonomikisht të qëndrueshme pa mbishfrytëzuar burimet biologjike detare;

v. të promovojnë zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës për të kontribuar në furnizimin me ushqim dhe sigurinë ushqimore, si dhe punësimin;

vi. të kontribuojnë në sigurimin e një standardi të drejtë jetese për ata që varen nga aktivitetet e peshkimit, duke marrë parasysh peshkimin bregdetar dhe aspektet socio-ekonomike;

vii. të kontribuojnë në një treg të brendshëm efikas dhe transparent për produktet e peshkimit e të akuakulturës dhe për të siguruar një mjedis të barabartë për produktet e peshkimit dhe akuakulturës që tregtohen në Shqipëri;

viii. të marrin parasysh interesat e konsumatorëve dhe të prodhuesve;



ix. të promovojnë aktivitetet e peshkimit bregdetar, duke marrë parasysh aspektet socio-ekonomike;

x. të jenë në përputhje me legjislacionin mjedisor, veçanërisht me objektivin e arritjes së statusit të mirë mjedisor, siç parashikohet në ligjin për strategjinë e mbrojtjes së mjedisit detar.

3. Në zbatim të politikës së peshkimit:

a) masat e ruajtjes e të menaxhimit të burimeve biologjike detare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) masat për menaxhimin e flotës që shfrytëzon burimet biologjike detare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) përfshirja e institucioneve të tjera në marrjen dhe zbatimin e masave menaxhuese të burimeve biologjike detare miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Në nenin 30 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Një anije peshkimi mund të përdoret për shfrytëzim tregtar të burimeve të gjalla ujore vetëm nëse ka një leje të vlefshme peshkimi.”

2. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Leje të reja peshkimi jepen vetëm:

a) për anije peshkimi me kapacitet peshkimi, shprehur si shuma e tonazhit me fuqinë motorike, më të vogël ose të barabartë me një anije peshkimi me leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj;

b) si zëvendësim i një anijeje të mbytur peshkimi, me kapacitet peshkimi të barabartë ose më të vogël se anija e mbytur, e cila ishte e pajisur me një leje të vlefshme peshkimi në kohën e ngjarjes. Në këtë rast kërkesën për leje peshkimi e bën pronari i anijes ose trashëgimtarët e tij;

c) për anije peshkimi të rrëmbyera, të cilat ishin të pajisura me leje të vlefshme peshkimi në kohën e ndodhjes së ngjarjes. Subjekt i këtij zëvendësimi janë anijet e rrëmbyera pas vitit 2011;

ç) për anije peshkimi që ushtrojnë aktivitet peshkimi në detet e hapura, jashtë detit Mesdhe.”

3. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. Rregullat dhe procedurat për zëvendësimin e anijeve të peshkimit miratohen me udhëzim të ministrit.”

Neni 6

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

Peshkimi në detet e hapura

1. Leja e peshkimit në det të hapur lëshohet vetëm në rastet kur:

a) anija e peshkimit ka kapacitet për të lundruar në det të hapur të vërtetuar nga shoqëria klasifikuese që vepron në emër të administratës detare;

b) është marrë informacion në përputhje me Organizatën Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit (në vijim “ORMP”) në zonën përkatëse dhe informacion për të dhënat e anijes së peshkimit dhe anijen e saj mbështetëse, nëse ka;

c) anija e peshkimit dhe çdo anije mbështetëse e lidhur me të, nëse ka, është e pajisur me numrin e identifikimit IMO;

ç) anija e peshkimit nuk përfshihet në listën e anijeve PPP, të miratuar nga ministri, nga një ORMP dhe nga Komisioni Evropian;

d) anija ka një gjatësi të përgjithshme mbi 24 metra.

2. Rregullat për lëshimin e lejes për peshkim në det të hapur miratohen me udhëzim ministri.

3. Lejet e peshkimit në det të hapur nuk përfshijnë zëniet e llojeve shumë migruese dhe llojet ndërzonale.”

Neni 7

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34

Peshkimi jashtë ujërave territoriale

E drejta e peshkimit jashtë ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë përcaktohet në lejen e peshkimit tregtar.”

Neni 8

Në nenin 34/1 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Anijet e peshkimit bregdetar artizanal mund të jenë të përfshira në një nga format e organizimit të përcaktuara në pikën 1 të nenit 58 të këtij ligji, me



qëllim bashkërendimin dhe menaxhimin e peshkimit artizanal në shkallë të vogël.”

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) shkronjat “d” dhe “dh” ndryshohen si më poshtë:

“d) peshkaqenët dhe rajat - *Cetorhinus maximus*, *Carcharodon Carcharias*, *Squatina squatina*, *Hexanchus griseus*, *Rostroraja alba*, gjinia *Pristidae*, familja *Rhinobatidae*, *Alopiidae*, *Carcharhinidae*, *Sphyrnidae*, *Lamnidae*,

dh) lopa e detit - gjinia *Mobula*.”

b) pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

“i) molusqe bivalvore - *Pinna nobilis*, *Pholas dactylus*,

j) iriq deti - *Centrostephanus longispinus*.”

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ndalohet heqja e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijes, mbajtja në bord, trasbordimi ose zbarkimi i tyre.

1/2. Ndalohet shitja, blerja dhe hedhja në treg e pendëve të peshkaqenëve që janë hequr në kundërshtim me pikën 1/1 të këtij neni.

1/3. Përrjashtimisht përcaktimeve të pikës 1/1, me qëllim lehtësimin e procedurave të ruajtjes dhe magazinimit në bord, lejohet prerja e pjesshme dhe palosja e pendëve të peshkaqenëve.”

Neni 10

Në nenin 61/1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës “d” të pikës 2 shtohen fjalët “nëpërmjet planeve të prodhimit dhe marketingut”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Forma dhe përmbajtja e planeve të prodhimit dhe marketingut miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 11

Neni 64 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 64

Transferimi i menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit

1. Organizata e peshkimit, që plotëson kushtet e nenit 62 të këtij ligji, merr në menaxhim infrastrukturën e peshkimit.

2. Organizata e peshkimit menaxhon infrastrukturën e peshkimit në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) përballimi i kostove të përdorimit e të mirëmbajtjes;

b) aksesimi i barabartë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e përdoruesve;

c) përputhshmëria me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit;

ç) zhvillimi i qëndrueshëm.

3. Në rastin kur infrastruktura e peshkimit menaxhohet nga një organizatë peshkimi, veprohet si më poshtë:

a) çdo mjet lundrues peshkimi, që është pronë ose drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, lejohet të përdorë portin ose qendrën e peshkimit që i është transferuar organizatës;

b) personat, të cilët nuk janë anëtarë të organizatës, lejohen të hyjnë në port ose në qendrën e peshkimit;

c) çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon portin apo qendrën e peshkimit që i është transferuar një organizate dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e portit ose të qendrës së peshkimit dhe me rregulloret e organizatës;

ç) tarifatat që organizata ofron për shërbimet për një mjet lundrues, që është pronë a drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, janë më të larta se tarifatat për mjetet lundruese të anëtarëve të saj, por, në çdo rast, jo më shumë se dyfishi i tyre.

4. Tarifatat sipas shkronjës “ç” të pikës 3 të këtij neni miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për peshkimin pas konsultimit me organizatën e peshkimit.”

Neni 12

Titulli i kreut VIII ndryshohet dhe zëvendësohet me “Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin”.



Neni 13

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 65

Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës menaxhon në mënyrë të drejtpërdrejtë infrastrukturën e peshkimit dhe të lidhur me peshkimin ose kryen procedurat e transferimit të menaxhimit të tyre.

2. Menaxhimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimin transferohet te njësia e vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet kjo infrastrukturë e lidhur me peshkimin.

3. Në rast se njësia e vetëqeverisjes vendore nuk shpreh interes për menaxhimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, kjo infrastrukturë u transferohet me konkurrim publik subjekteve tregtare.

4. Përcaktimi i kriterëve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 14

Në nenin 69 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Një anije peshkimi me flamur shqiptar, që kryen aktivitet në ujërat shqiptare, autorizohet të kryejë aktivitete specifike peshkimi vetëm për aq sa ato tregohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi kur peshkimi ose zonat e peshkimit ku autorizohen aktivitetet i nënshtrohen:

- a) një regjimi sforcoje peshkimi;
 - b) një plani shumëvjeçar;
 - c) një zone të kufizuar peshkimi;
 - ç) peshkimit për qëllime shkencore.”
2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 72 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministria ngrë një sistem monitorimi të anijeve me bazë satelitore për monitorimin efektiv të aktiviteteve të peshkimit të anijeve të peshkimit me flamur shqiptar kudo që mund të jenë ato anije dhe të aktiviteteve të peshkimit të këtyre anijeve në ujërat ndërkombëtare.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ministria siguron që të dhënat e siguruar nga sistemi automatik i identifikimit në anijet e peshkimit i transmetohen QNOD-së dhe Inspektoratit të Peshkimit.”

3. Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1 dhe 8/2 me këtë përmbajtje:

“8/1. Një anije peshkimi me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 15 metra duhet të pajiset dhe të mbajë në funksion një sistem automatik identifikimi (AIS), i cili plotëson standardet e performancës, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO).

8/2. Ministria përdor të dhënat e sistemit të identifikimit automatik, kur të dhënat e tilla janë të disponueshme për qëllime të kryqëzimit me të dhënat e tjera të disponueshme.”

4. Në pikën 9 togfjalëshi “i pikës 1” zëvendësohet me togfjalëshin “i pikave 1 dhe 8/1”.

Neni 16

Në nenin 73 pas fjalëve “me sistem monitorimi” shtohet fjala “satelitor.”

Neni 17

Në pikën 1 të nenit 81 fjalët “të paktën 24 orë para mbërritjes së tyre” zëvendësohen me fjalët “të paktën 3 ditë pune përpara momentit të parashikuar të mbërritjes në port”.

Neni 18

Pas pikës 3 të nenit 109 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 19

Pika 3 e nenit 118 ndryshohet si më poshtë:



“3. Përcaktimi i rregullave të inspektimit për parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar e të parregulluar, dhe skema e certifikimit të zënieve në peshkim miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 20

Në nenin 121 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.
2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Manuali i detyrave dhe përgjegjësive të inspektorëve për peshkimin hartohet nga institucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror dhe miratohet nga ministri.”.

Neni 21

Neni 127 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 127

Subjektet përgjegjëse të kundërvajtjeve administrative

1. Çdo person fizik ose juridik, që ushtron aktivitet peshkimi, është përgjegjës për shkeljet e kryera sipas nenit 128 të këtij ligji, në interes të tij, ose për shkeljet e kryera nga çdo person që vepron në emër të këtij personi fizik ose juridik ose për shkeljet e kryera nga çdo person i punësuar prej tij.

2. Personat, që veprojnë në emër ose për llogari të personit fizik ose juridik, janë përgjegjës për shkeljet e kryera sipas nenit 128 të këtij ligji kur vërtetohet se shkeljet janë kryer kundër vullnetit të personit fizik ose juridik.

3. Çdo person tjetër, që nuk përfshihet në rastet e parashikuara sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, konsiderohet përgjegjës për shkeljet e kryera sipas nenit 128 të këtij ligji.”.

Neni 22

Neni 128 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 128

Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) hedhja e mbeturinave të lëngshme apo të ngurta, që krijojnë efekte negative në cilësinë e mjedisit ujor, në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “a” të nenit 7 të këtij ligji, dënohet sipas legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

b) lëshimi i llojeve të peshkut joindigjenë dhe/ose organizmave të tjerë ujorë, llojeve të peshkut të modifikuara gjenetikusht ose organizmave të tjerë ujorë, në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “b” të nenit 7 të këtij ligji, në hapësirën detare dhe në ujëra të brendshme, dënohet me gjobë në masën 300 000 lekë.

c) aktivitetet nënujore, që synojnë peshkimin në vende ku nuk është marrë më parë leje prej autoritetit menaxhues përgjegjës, në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “c” të nenit 7 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 30 000 lekë.

ç) zënia e të vegjëlve, llojeve të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë të paarrirë për t'u riprodhuar ose me përmasa më të vogla se ato të parashikuara në aktet nënligjore, në kundërshtim me përcaktimin e këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 100 000 lekë deri 1 000 000 lekë, si dhe shoqërohet me sekuestrimin e prodhimit të peshkuar nën dimension.

d) ushtrimi i aktivitetit të peshkimit dhe marrja ose shkatërrimi i faunës dhe florës në zonat e mbrojtura ujore, në kundërshtim me përcaktimin e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 500 000 lekë.

dh) hedhja apo shfrytëzimi i rërës ose zhavorrit, shkarkimi apo zhvendosja e ujërave apo çdo materiali tjetër ndotës, si edhe ndërhyrja, prishja apo shkatërrimi i mjedisit në zonat e mbrojtura ujore, në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën nga 400 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

e) ndërtimi i strukturave në tokë apo në ujë në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 600 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.

ë) ndërmarrja apo kryerja e aktiviteteve të tjera që mund të kenë një ndikim negativ mbi ekosistemin e zonës së mbrojtur në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 200 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

f) zënia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë në kundërshtim me urdhrin për ndalimin e



peshkimit, jashtë sezonit apo në zonat ku nuk lejohet peshkimi, në kundërshtim me përcaktimin e neneve 13 dhe 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 200 000 lekë deri në 1 000 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrimin e produkteve të peshkuara.

g) zënia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë me eksplozivë, substanca kimike ose çdo mënyrë tjetër që vret, intoksikon apo helmon, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 1 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

gj) mbajtja në bord apo në breg e eksplozivëve apo substancave kimike që vrasin, helmojnë apo intoksikojnë peshkun dhe organizmat e tjerë ujorë, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 2 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 1 500 000 lekë.

h) përdorimi dhe mbajtja në anije e substancave apo pajisjeve, sipas pikës 3 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 lekë deri në 2 500 000 lekë.

i) shkelja e pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë.

j) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit në kundërshtim me përcaktimin e pikave 5 e 6 të nenit 16 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 500 000 lekë:

k) ushtrimi i aktivitetit të peshkimit, pa qenë i pajisur me leje apo në kundërshtim me kushtet e parashikuara në të, sipas përcaktimit të nenit 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë dhe shoqërohet me sekuestrim të produkteve të peshkuara:

i. në masën 200 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet në kundërshtim me kushtet e parashikuara në leje;

ii. në masën 1 000 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet pa qenë i pajisur me leje.

l) shkelja e përcaktimit të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

ll) shkelja e përcaktimit të nenit 34 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 250 000 lekë.

m) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit prej një anijeje të huaj në ujërat e Republikës së Shqipërisë dënohet me gjobë në masën nga 3 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë, si dhe sekuestrohen produktet e peshkuara. Shpenzimet e ruajtjes e të mirëmbajtjes së anijes së bllokuar përballohen nga kundërvajtësi.

n) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit prej një anijeje me flamur të huaj në Zonën Ekskluzive Ekonomike të Republikës së Shqipërisë pa qenë e pajisur me leje për këtë qëllim dënohet me gjobë në masën nga 200 000 lekë deri në 600 000 lekë. Anija e peshkimit qëndron e bllokuar deri në pagesën e plotë të gjobës së vendosur. Shpenzimet e ruajtjes e të mirëmbajtjes së anijes së bllokuar përballohen nga kundërvajtësi.

nj) peshkimi, mbajtja në bord, transitimi në barkë dhe anije, zbarkimi i qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum e llojeve të mbrojtura të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 1 të nenit 37 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën nga 100 000 lekë deri në 1 000 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrimin e zënieve.

o) heqja e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijes, mbajtja në bord, trasbordimi, zbarkimi i qëllimtë, shitja dhe hedhja në treg e këtyre pendëve, në kundërshtim me përcaktimin e pikave 1/1 dhe 1/2 të nenit 37 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrimin e produktit.

p) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit çlodhës - argëtues në kundërshtim me përcaktimin e pikës 2 të nenit 38 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë.

q) mbledhja dhe/apo tregtia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë të zënë me eksplozivë, substanca kimike ose çdo mënyrë tjetër që vret, intoksikon apo helmon, dënohet me gjobë në masën nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrim të produkteve.

r) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit amator pa qenë i pajisur me autorizimin përkatës ose në kundërshtim me përcaktimin e neneve 40 e 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë.

rr) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit turistik pa qenë i pajisur me autorizimin përkatës ose në kundërshtim me përcaktimin e neneve 40 e 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

s) ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit çlodhës - argëtues në kundërshtim me përcaktimin e nenit 45 të këtij ligji dënohet me gjobë:

i. në masën 5 000 lekë pa mjet lundrues;

ii. në masën 50 000 lekë në rast se për kryerjen e shkeljes përdoret mjet lundrues.

sh) cilido që zhvillon veprimtari studimore dhe shkencore pa autorizimin, sipas nenit 49 të këtij ligji,



ose në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në autorizim, dënohet me gjobë:

i. në masën 100 000 lekë në rast se veprimtaria studimore dhe shkencore zhvillohet në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në autorizim;

ii. në masën 300 000 lekë në rast se veprimtaria studimore dhe shkencore zhvillohet pa autorizim.

t) ushtrimi i peshkimit, pa qenë i pajisur me autorizim apo në kundërshtim me kushtet e parashikuara në të, sipas përcaktimit të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë dhe shoqërohet me sekuestrimin e produkteve të peshkuara:

i. në masën 200 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet në kundërshtim me kushtet e parashikuara në autorizim;

ii. në masën 1 000 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet pa qenë i pajisur me autorizim.

th) mosshënjimi i mjeteve lundruese dhe veglave të peshkimit sipas nenit 70 të këtij ligji dënohet me gjobë:

i. në masën 5 000 lekë për mosshënjimin e veglave të peshkimit;

ii. në masën 10 000 lekë për mosshënjimin e mjeteve lundruese.

u) mosinstalimi i pajisjeve ose dëmtimi i tyre sipas pikës 1 të nenit 72 të këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:

i. manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit e tyre për një periudhë të caktuar kohe në masën 500 000 lekë;

ii. nxjerrja jashtë përdorimit përfundimisht në masën 1 000 000 lekë, si dhe ndalimi i aktivitetit të peshkimit të mjetit lundrues në fjalë deri në bërjen funksionale të pajisjeve. Shpenzimet e riparimit ose zëvendësimit të tyre përballen nga kundërvajtësi.

v) mosinstalimi, dëmtimi, manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit për një periudhë të caktuar kohe i pajisjeve sipas pikës 8/1 të nenit 72 të këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:

i. mosinstalimi në masën 200 000 lekë;

ii. manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit për më pak se 2 (dy) orë, në masën 100 000 lekë;

iii. manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit për mbi 2 (dy) orë, në masën 500 000 lekë.

x) mosrespektimi i detyrimeve në lidhje me regjistrimin dhe deklarimin e të dhënave në lidhje me zëniet ose të dhënave të lidhura me to në librin e anijes, të regjistrimit elektronik, të lajmërimit

paraprak dhe deklaratën e zbarkimit sipas detyrimeve të neneve 74 deri 82 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 5 000 lekë për çdo regjistrim dhe deklaram të parealizuar sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në nenet 74 deri 82 të këtij ligji.

xh) mosrespektimi i detyrimeve sipas nenit 83 të këtij ligji në lidhje me deklaratën e zbarkimit, dënohet me gjobë në masën nga 5 000 lekë deri në 10 000 lekë.

y) peshkimi mbi normat e lejuara në zonat e peshkimit për të cilat ka një regjim të përcaktuar peshkimi, si dhe shkelja e procedurave të përcaktuara në nenet 88 deri 90 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, si dhe shoqërohen me sekuestrimin e sasive mbi kuotat e lejuara.

z) shkeljet nga ana e anijeve të peshkimit që nuk janë të pajisura me sistemin e monitorimit në anije apo që nuk transmetojnë të dhënat e librit të anijes së peshkimit dhe që janë subjekt i një regjimi sforcoje peshkimi sipas përcaktimeve në nenet 91 dhe 92 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

zh) transbordimi i zënieve nga një anije në tjetrën, në porte ose vende të pamiratuara sipas përcaktimeve të nenit 99 të këtij ligji dhe në kundërshtim me nenin 98 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.

aa) përdorimi i një fuqie tjetër motorike, zëvendësimi i saj me një tjetër motor me tjetër fuqi apo përdorimi i një fuqie tjetër të modifikuar teknikisht, kur kjo e fundit nuk është certifikuar zyrtarisht nga shoqëria klasifikuese që vepron në emër të administratës detare, në shkelje të nenit 102 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 50 000 lekë.

bb) shkeljet e përcaktimeve të neneve 105 dhe 106 të këtij ligji dënohen me gjobë në masën 100 000 lekë, si dhe shoqërohen me kontrollin e anijes së peshkimit në daljen e saj më të parë në port.

cc) shkelja e nenit 107 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë.

çç) shkelja e nenit 108 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

dd) mosparaqitja e certifikatës së origjinës së produkteve peshkore me qëllim identifikimin e zonës përkatëse të origjinës nga operatorët përgjegjës për zënie, shitjen, magazinimin ose transportimin e tyre në shkelje të pikës 2 të nenit 109 të këtij ligji, si dhe shkelja e përcaktimit të pikës 1 të



nenit 110 dhe të pikës 1 të nenit 111 të këtij ligji dënohen me gjobë në masën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, si dhe shoqërohen me sekuestrim të produkteve.

dhdh) hedhja në treg, importi ose eksporti i prodhimeve peshkore nga peshkimi PPP për rastet e tjera të paparashikuara në pikat e mësipërme të këtij neni përbëjnë shkelje, të cilat dënohen me gjobë sa pesëfishi i vlerës së prodhimeve peshkore, si dhe shoqërohet me sekuestrimin e tyre.

ee) përdorimi i veglave jo të autorizuar ose në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në shkelje të shkronjës “ë” të nenit 117 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë, si dhe shoqërohet me sekuestrimin e këtyre veglave të peshkimit.

2. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Në rast se shkeljet janë kryer nga mjete lundruese të peshkimit tregtar artizanal, në bregdet dhe ujëra të brendshme, aplikohet gjysma e masës së gjobës, parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Në rast të përsëritjes të së njëjtës shkelje brenda një periudhe 6-mujore nga shkelja e mëparshme, për shkeljen e re aplikohet dyfishi i vlerave të gjobave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

5. Në rast se gjatë shkeljeve janë zënë specie shumë migratore, si toni i kuq (*Thunnus thynnus*) dhe peshku shtizë (*Xiphias gladius*), aplikohet dyfishi i masës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

6. Ministri miraton metodologjinë e hartuar nga inspektorati që mbulon fushën e peshkimit për sa i përket përcaktimit të masës administrative për shkeljet e listuara në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 23

Neni 131 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 131
Ankimi

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit, që mbulon fushën e peshkimit për marrjen e masave urgjente, dënimin me gjobë dhe vendosjen e dënimeve plotësuese bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin dhe paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të masës administrative.

2. Ankimi ndaj vendimit për dhënien e miratimit ose mosmiratimit për lejen e peshkimit paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

Neni 24

Neni 132 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 132

Komisioni për Shqyrtimin e Ankimeve

1. Për shqyrtimin e ankesave ndaj masave administrative të marra nga inspektorët e peshkimit, gjatë kryerjes së një inspektimi dhe për shqyrtimin e ankesave për lejet e peshkimit, në ministri ngrihet Komisioni për Shqyrtimin e Ankimeve, në përbërje të të cilit janë pesë anëtarë.

2. Ngritja, përbërja dhe funksionimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankimeve miratohet me urdher ministri.”.

Neni 25

Dispozitë kalimtare

Pika 8/1 e nenit 72 zbatohet:

a) duke filluar nga data 1 janar 2025 për anijet e peshkimit me gjatësi mbi 24 metra;

b) duke filluar nga data 1 qershor 2025 për anijet e peshkimit me gjatësi 18-24 metra;

c) duke filluar nga data 1 janar 2026 për anijet e peshkimit me gjatësi 15-18 metra.

Neni 26

Në nenin 135 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 23; të pikës 2/1 të nenit 61/1; të pikës 4 të nenit 65 dhe të pikës 4 të nenit 109 brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ngarkohet ministri përgjegjës për peshkimin për miratimin e akteve nënligjore në



zbatim të pikës 12 të nenit 30; të pikës 2 të nenit 30/1; të pikës 4 të nenit 64; të pikës 4 të nenit 121; të pikës 6 të nenit 128 dhe të pikës 2 të nenit 132 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”

3. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.9.2024.

Shpallur me dekretin nr. 353, datë 9.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 353, datë 9.10.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 98/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012, ‘Për peshkimin’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 103/2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 72/2012, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”²**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 10 shtohen pikat 10/1 dhe 10/2 me këtë përmbajtje:

“10/1. “Harta bazë” është një hartë që përshkruan apo paraqet informacione gjeohapësinore të realitetit fizik të sipërfaqes së tokës për të cilën vendosen, përpunohen dhe përditësohen informacione të tjera tematike, sipas temave të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji.

10/2 “Remote Sensing” është teknologjia shkencore e përfundimit të të dhënave, paraqitjes dhe njohjes së informacionit mbi sipërfaqen tokësore dhe të objekteve mbi të, pa qenë në kontakt me to. Kjo mundësohet me anë të “kapjes” së ndijimeve (skanimit) dhe regjistrimit të energjisë së rrezatimit të reflektuar dhe të emetuar nga objektet në dhe mbi sipërfaqen tokësore dhe më pas të përpunimit, të analizimit dhe të përdorimit të informacionit të përfutur.”.

Evropian (INSPIRE)”. Numri CELEX: 32007L0002, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 108, datë 25.4.2007, faqe 1–14.

² Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

Direktivën 2007/2/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007, “Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Faqe | 20108



2. Pika 20 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenet 6, pika 3, 10, pika 2, 11, pika 3, 13, pikat 1, 2, shkronja “a”, dhe 4, 16, pika 1 dhe 19, pika 3, fjalët “me propozimin e ministrit”, “të propozuar nga ministri” dhe “sipas propozimit të ministrit” hiqen.

Neni 3

Pika 1 e nenit 6 ndryshohet si më poshtë:

“1. ASIG-u është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të Kryeministrit.”.

Neni 4

Në nenin 7 pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

“i) mbledh, analizon, administron, përpunon me teknologji të avancuar dhe shpërndan informacionin gjeohapësinor të mbledhur me metodat pasive dhe aktive të *Remote Sensing*-ut;

j) krijon dhe mirëmban hartën bazë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 5

Në nenin 8 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Titulli zëvendësohet me “drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut”.

2. Në pikën 1 emërtimi “Drejtori i ASIG-ut” zëvendësohet me emërtimin “drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri.”.

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtori i përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të zotërojë të paktën diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional” të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike;

ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në pozicione drejtuese;

d) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepr penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesave.”.

5. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Drejtori i përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

a) ka mbushur moshën për pension;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) ristrukturohet institucioni;

ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

d) jep dorëheqjen nga detyra;

dh) humbet shtetësinë shqiptare;

e) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

5. Drejtori i përgjithshëm shkarkohet nga detyra kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;

b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;

c) nuk përmbush objektivat strategjike të institucionit për shkak të performancës së ulët të tij;

ç) i shkakton, për shkak të paaftësisë profesionale a të neglizhencës, dëm institucionit ose imazhit të tij.”.

Neni 6

Pika 2 e nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

“2. Struktura dhe organika e ASIG-ut miratohen nga Kryeministri në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Neni 7

Në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 11 fjalët “imazhi i hartës bazë” zëvendësohen me fjalët “hartë bazë”.



Neni 8

Pika 3 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“3. Autoritetet publike depozitojnë menjëherë pranë ASIG-ut informacionin gjeografik, të krijuar sipas pikës 2 të këtij neni.”

Neni 9

Në pikën 3 të nenit 18 fjalët “ia përcjell ato ministrit për propozim” zëvendësohen me fjalët “i përcjell”.

Neni 10

Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli zëvendësohet me “Koordinimi ndërinstitucional”.

2. Në pikën 1 fjalët “bashkërendimin ndërinstitucional” zëvendësohen me fjalët “koordinimin ndërinstitucional”.

Neni 11

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Monitorimi dhe raportimi

1. ASIG-u monitoron procesin e krijimit dhe përdorimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor (NSDI) në Republikën e Shqipërisë.

2. ASIG-u përgatit raporte periodike për ecurinë e NSDI-së në Shqipëri, sipas modelit të përcaktuar në rregullat e legjislacionit evropian dhe ua vë në dispozicion institucioneve shqiptare dhe organeve të BE-së.”

Neni 12

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Ofrimi i të dhënave dhe shërbimeve

1. Të dhënat gjeohapësinore, të vëna në dispozicion nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, sipas pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, që përfshihen në listën e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe, sipas legjislacionit për të dhënat e hapura dhe

ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, ofrohen pa pagesë nga ASIG-u.

2. Të dhënat dhe shërbimet e ASIG-ut, që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, mund të ofrohen kundrejt një tarife.

3. Lista e të dhënave dhe shërbimeve që do të tarifohen, si dhe masa e tarifës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 13

Në pikën 2 të nenit 28 referenca “18” zëvendësohet me referencën “16”.

Neni 14

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.9.2024

Shpallur me dekretin nr. 354, datë 9.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 354, datë 9.10.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 103/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2012, ‘Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 104/2024

**PËR PRODHIMIN ORGANIK,
ETIKETIMIN E PRODUKTEVE
ORGANIKE DHE KONTROLLIN E TYRE³**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave për prodhimin organik lidhur me certifikimin dhe përdorimin e treguesve, që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim, si dhe i rregullave për kontrollin zyrtar, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për produktet me origjinë nga bujqësia, përfshirë akuakulturën, bletarinë dhe produktet e prejardhura prej tyre, kur këto produkte prodhohen ose synohen të prodhohen, të përgatiten, të etiketohen, të shpërndahen, të vendosen në treg dhe të importohen ose të eksportohen si më poshtë:

a) produkte bujqësore të gjalla ose të papërpunuara, përfshirë farat dhe materiale të tjera mbjellëse dhe shumëzuese bimore;

b) produkte bujqësore të përpunuara për t'u përdorur si ushqim;

c) ushqime për kafshë;

³ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (BE) nr. 2018/848, të datës 30 maj 2018, "Mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e rregullores së

ç) produkte të tjera të lidhura ngushtë me bujqësinë, nëse ato prodhohen ose synohen të prodhohen, të përgatiten, të etiketohen, të shpërndahen, të vendosen në treg, të importohen ose të eksportohen, të përcaktuara me urdhër të ministrit.

2. Ky ligj zbatohet për çdo operator të përfshirë në çdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së produkteve organike, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet e *catering*-ut, të kryera nga një operator *catering*-u, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit.

4. Ky ligj zbatohet pa prekur dispozitat ligjore në fuqi për sigurinë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

5. Ky ligj zbatohet pa prekur dispozitat e legjislacionit në fuqi për organizimin e tregut për produktet bujqësore, si dhe etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit.

6. Produktet organike të prodhuara dhe të përgatitura në Shqipëri dhe që synohen të vendosen në tregun shqiptar certifikohen sipas rregullave të këtij ligji.

**Neni 3
Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Aditiv ushqimor" ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për aditivët ushqimorë të lejuar.

2. "Aditiv ushqimor për ushqim për kafshë" janë substanca, mikroorganizma ose preparate, por jo lëndët e para për ushqimet për kafshë dhe as përzierjet paraprake të tyre, të cilat u shtohen qëllimisht ushqimeve për kafshë ose ujit për të kryer në veçanti një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme:

a) ndikon në përmirësimin e vetive të ushqimeve për kafshë;

Këshillit (KE) nr. 834/2007. Numri CELEX: 32018R0848, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 150, datë 14.6.2018, faqe. 1–92.



b) ndikon në përmirësimin e karakteristikave të produkteve shtazore;

c) ndikon në përmirësimin e ngjyrës së peshqve dhe shpendëve ornamentalë;

ç) plotëson nevojat ushqyese të kafshëve;

d) ndikon në përmirësimin e ndikimit mjedisor të prodhimit shtazor;

dh) ndikon në përmirësimin e prodhimit shtazor, gjendjen e përgjithshme ose mirëqenien e kafshëve, duke ndikuar sidomos në florën gastro-intestinale ose tretshmërinë e ushqimeve për kafshë; ose

e) ka efekt kokcidiostatik ose histomonostatik.

3. “Akuakulturë” ka kuptimin e dhënë në ligjin për akuakulturën.

4. “Bimë” ka kuptimin e dhënë në ligjin për mbrojtjen e bimëve.

5. “Bimë mëmë” është bimë e identifikuar, nga e cila është marrë material mbjellës dhe shumëzues bimor për të riprodhuar bimë të reja.

6. “Brezni” është një grup bimësh, të cilat i përkasin një stadi të vetëm në vijën e prejardhjes së bimëve.

7. “Certifikatë zyrtare” është një dokument në letër ose elektronik, i nënshkruar nga zyrtari certifikues dhe që ofron siguri në lidhje me përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

8. “Dëmtues” ka kuptimin e dhënë në ligjin për mbrojtjen e bimëve.

9. “Ekuivalencë” është plotësimi i objektivave dhe parimeve të njëjta duke zbatuar rregulla, të cilat sigurojnë të njëjtin nivel sigurie të përputhshmërisë.

10. “Etiketimi” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.

11. “Fazë e prodhimit, e përgatitjes dhe e shpërndarjes” është çdo fazë nga prodhimi primar i një produkti organik, ruajtja, përpunimi, transporti e deri te shitja ose furnizimi te konsumatori i fundit, ku përfshihen, nëse është e nevojshme, etiketimi, reklamimi, importi, eksporti dhe aktivitetet e nënkontraktuara.

12. “Fermë” është tërësia e të gjitha njërive prodhuese, që veprojnë nën një menaxhim të vetëm, me synim prodhimin e produkteve bujqësore të gjalla ose të papërpunuara, përfshirë produktet nga akuakultura dhe bletaria, me përjashtim të vajit esencial dhe majasë.

13. “Fermer” është një person fizik ose juridik apo një grup personash fizikë ose juridikë, të cilët,

pavarësisht nga forma e organizimit të grupit dhe anëtarëve të tij, ushtrojnë një aktivitet bujqësor.

14. “Fatkeqësi natyrore” është një ngjarje natyrore e një natyre biotike ose abiotike, që sjell shqetësime të rëndësishme në sistemet e prodhimit bujqësor ose pyjor, duke shkaktuar dëme të rëndësishme ekonomike në sektorët e bujqësisë ose pyjeve.

15. “Gjurmueshmëria” është aftësia për të gjurmuar dhe për të ndjekur ushqimin, ushqimin për kafshë ose çdo produkt të përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji, dhe çdo substancë që synohet ose pritet të përfshihet në ushqim, ushqim për kafshë ose çdo produkt të përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.

16. “Integritet i produkteve organike ose në kalim” është mungesa e shfaqjes së një mospërputhjeje nga produkti, e cila:

a) ndikon në çdo fazë të prodhimit, të përgatitjes dhe të shpërndarjes në karakteristikat e produktit organik ose në kalim;

b) është e përsëritur ose është e qëllimshme.

17. “Incident mjedisor” është një dukuri e veçantë e ndotjes, kontaminimit ose degradimit të cilësisë së mjedisit, që lidhet me një ngjarje të veçantë dhe është me shtrirje gjeografike të kufizuar, por nuk përfshin rrisqet e përgjithshme mjedisore, që nuk lidhen me një ngjarje të veçantë, si ndryshimet klimatike ose ndotja atmosferike.

18. “I prodhuar me OMGJ” është produkti i prodhuar, duke përdorur një OMGJ si organizëm i fundit i gjallë në procesin e prodhimit, por që nuk përmban ose përbëhet nga OMGJ-të dhe as është i prodhuar nga OMGJ-të.

19. “I prodhuar nga OMGJ” është produkti i prodhuar tërësisht ose pjesërisht nga OMGJ, por që nuk përmban ose përbëhet nga OMGJ.

20. “Kalim” është faza e ndërmjetme e kalimit nga prodhimi joorganik në atë organik, brenda një periudhe të caktuar gjatë së cilës zbatohen kërkesat e këtij ligji.

21. “Komisioni për Prodhimin Organik (KPO)” është autoriteti që vepron në ministri sipas nenit 46 të këtij ligji.

22. “Lëndë ndihmëse për përpunimin” është çdo substancë, e cila:

a) në ushqim:

i. nuk konsumohet si ushqim në vetvete;



ii. përdoret qëllimisht në përpunimin e lëndëve të para, ushqimeve ose përbërësve të tyre, për të arritur një qëllim të caktuar teknologjik gjatë trajtimit ose përpunimit;

iii. mund të rezultojë në praninë e paqëllimshme, por teknikisht të pashmangshme në produktin përfundimtar të mbetjeve të kësaj substance ose derivateve të saj, me kusht që ato të mos paraqesin ndonjë rrezik për shëndetin dhe të mos kenë asnjë efekt teknologjik në produktin ushqimor përfundimtar.

b) në ushqimin për kafshë nuk konsumohet si ushqim për kafshë në vetvete, por përdoret qëllimisht në përpunimin e produkteve ushqimore ose ushqimeve për kafshë për të arritur një qëllim teknologjik gjatë trajtimit ose përpunimit, i cili mund të rezultojë në praninë e paqëllimshme, por teknologjikisht të pashmangshme të mbetjeve të kësaj substance ose të derivateve të saj në produktin përfundimtar, me kusht që këto mbetje të mos kenë efekt negativ në shëndetin e kafshëve, të njerëzve ose në mjedis dhe të mos kenë asnjë efekt teknologjik në ushqimin përfundimtar për kafshë.

23. “Masa parandaluese” janë masat që merren nga operatorët në çdo fazë të prodhimit, të përgatitjes dhe të shpërndarjes, për të siguruar ruajtjen e biodiversitetit dhe cilësisë së tokës, për të parandaluar dhe për të luftuar sëmundjet e dëmtuesit dhe për të shmangur ndikimet negative në mjedis, në shëndetin e kafshëve dhe të bimëve.

24. “Masa paraprake” janë masat që merren nga operatorët në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes për të shmangur ndotjen me produkte ose substanca, të cilat nuk lejohen të përdoren në prodhimin organik dhe për të shmangur shkëmbimin e produkteve organike me produkte joorganike.

25. “Material organik heterogjen” është një grupim bimësh, që i përket një kategorie taksonomike të vetme botanike të rangut më të ulët të njohur, të cilat:

a) shfaqin karakteristika të përbashkëta fenotipike;

b) karakterizohen nga një shkallë e lartë diversiteti gjenetik dhe fenotipik mes njërive individuale riprodhuese, në mënyrë që ky grupim bimësh të përfaqësohet nga materiali si një e tërë dhe jo nga një numër i vogël bimësh;

c) nuk janë një varietet;

ç) nuk janë një përzierje varietetesh;

d) janë prodhuar në përputhje me këtë ligj.

26. “Material mbjellës dhe shumëzues bimor” janë bimët dhe të gjitha pjesët e bimëve, përfshirë farat, në çdo fazë të rritjes, të cilat janë të afta dhe kultivohen me qëllim për të prodhuar sërish bimë.

27. “Ministria” është ministria përgjegjëse për bujqësinë, si autoritet kompetent qendror për bujqësinë organike.

28. “Ministri” është ministri përgjegjës për bujqësinë.

29. “Mospërputhje” është mungesa e përputhjes me kërkesat e këtij ligji.

30. “Moti i keq” janë kushtet e motit, të tilla si: ngrica, stuhi dhe breshër akulli, shiu i dendur ose thatësira e madhe, të cilat mund të konsiderohen si një fatkeqësi natyrore.

31. “Njësi prodhimi” është tërësia e të gjitha objekteve të një ferme, si vendet ku kryhet prodhimi primar, ngastrat e tokës, kullotat, hapësirat në natyrë, stallat e blegtorisë ose pjesë të tyre, zgjoje, pellgje peshku, impiante kultivimi për alga ose specie akuakulture, njësitë e rritjes së tyre, objekte në bregdet ose në det dhe mjediset për ruajtjen e bimëve, produkteve bimore, produkteve nga algat, produkteve shtazore, lëndëve të para dhe çdo inputi tjetër të rëndësishëm të menaxhuar, siç përshkruhet në pikat 32, 33 dhe 34 të këtij neni.

32. “Njësi prodhimi organik” është një njësi prodhimi, përjashtuar periudhën e kalimit të përcaktuar në nenin 10, e cila menaxhohet në përputhje me kërkesat që zbatohen për prodhimin organik.

33. “Njësi prodhimi në kalim” është një njësi prodhimi gjatë periudhës së kalimit sipas nenit 10, e cila menaxhohet në përputhje me kërkesat që zbatohen për prodhimin organik. Ajo mund të përbëhet nga ngastra toke, ferma blegtorale ose akuakulture, për të cilat periudha e kalimit fillon në momente të ndryshme kohore.

34. “Njësi prodhimi joorganik” është një njësi prodhimi, e cila nuk menaxhohet në përputhje me kërkesat që zbatohen për prodhimin organik.

35. “Operator” është një person fizik ose juridik, përgjegjës për të garantuar që ky ligj zbatohet në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, të cilat janë nën kontrollin e tij.

36. “Organizëm i modifikuar gjenetikisht (OMGJ)” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.



37. “Përbërës” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.

38. “Përgatitje” janë proceset e konservimit ose përpunimit të produkteve organike apo në kalim ose çdo proces/veprim tjetër, që kryhet mbi një produkt të papërpunuar, pa ndryshuar produktin fillestar, si: therja, prerja, pastrimi, grirja apo bluarja, si dhe ambalazhimi, etiketimi ose ndryshimet e bëra në etiketimin që i referohen prodhimit organik.

39. “Përpunim” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit, por nuk përfshin procesin e ambalazhimit dhe etiketimit.

40. “Prodhim bimor” është prodhimi i produkteve bujqësore, përfshirë mbledhjen e produkteve nga bimët e egra për qëllime tregtare.

41. “Prodhim organik” është zbatimi i metodave të prodhimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, përfshirë periudhën e kalimit të përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

42. “Prodhim blegtoral” është prodhimi i kafshëve tokësore shtëpiake ose të zbutura, përfshirë insektet.

43. “Produkte bimore” janë produktet me origjinë bimore, në gjendje të papërpunuar ose që u janë nënshtruar proceseve të përgatitjes së thjeshtë, si: bluarje, tharje ose shtypje, por duke përjashtuar bimët.

44. “Produkt organik” është produkti, i cili përfitohet nga prodhimi organik, por jo gjatë periudhës së kalimit, sipas nenit 10 të këtij ligji. Produktet e gjetisë ose peshkimit të kafshëve ose specieve të egra nuk konsiderohen produkte organike.

45. “Produkt në kalim” është një produkt i prodhuar gjatë periudhës së kalimit, sipas përcaktimit në nenin 10 të këtij ligji.

46. “Produkte për mbrojtjen e bimëve (PMB)” ka kuptimin e dhënë në ligjin për mbrojtjen e bimëve.

47. “Produkte të papërpunuara” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit, pavarësisht nga proceset e ambalazhimit dhe etiketimit.

48. “Produkte të përpunuara” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit,

pavarësisht nga proceset e ambalazhimit dhe etiketimit.

49. “Reklamim” është çdo paraqitje e produkteve për konsumatorin, me çdo mjet të ndryshëm nga etiketimi, që synon ose mund të ndikojë e të përcaktojë qëndrimet, bindjet dhe reagimet për të nxitur drejtpërdrejt ose tërthorazi shitjen e produkteve.

50. “Rrezatim jonizues” është transferimi i energjisë në formën e grimcave elementare ose valëve elektromagnetike, me gjatësi vale deri në 100 nanometër ose me frekuencë mbi 3x10¹⁵ Hertz, i aftë të prodhojë jone drejtpërdrejt ose tërthorazi.

51. “Sëmundje të kafshëve” janë sëmundjet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për veterinarinë.

52. “Trupë kontrolli” është:

a) një person juridik privat, i cili kryen kontrollin zyrtar të specializuar, me qëllim certifikimin e operatorit dhe grup-operatorëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;

b) një trupë kontrolli e njohur nga Komisioni Evropian ose që vepron në një vend të tretë të njohur nga Komisioni Evropian, me qëllim kryerjen e kontrollit në vendet e treta për importin e produkteve organike ose produkteve në kalim në Bashkimin Evropian, por që mund të importohen edhe në Shqipëri;

c) një trupë kontrolli që vepron në Shqipëri për certifikimin, sipas standardeve të tjera ndërkombëtare për prodhimin organik.

53. “Ushqim” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.

54. “Ushqim i paraambalazhuar” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.

55. “Ushqim për kafshë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.

56. “Variatet” ka kuptimin e dhënë në ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

57. “Variatet organik i përshtatshëm për prodhim organik” është një varietet, i cili:

a) karakterizohet nga një shkallë e lartë diversiteti gjenetik dhe fenotipik midis njësisive të veçanta riprodhuese;

b) është përftuar nga seleksionimi gjenetik organik.

58. “Vendosje në treg” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për ushqimin.



KREU II OBJEKTIVAT DHE PARIMET E PRODHIMIT ORGANIK

Neni 4

Objektivat e përgjithshëm të prodhimit organik

Objektivat e përgjithshëm për prodhimin organik janë si më poshtë:

- a) të kontribuojë për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës;
- b) të ruajë pjellorinë afatgjatë të tokës;
- c) të kontribuojë për një nivel të lartë biodiversiteti;
- ç) të kontribuojë në mënyrë të qëndrueshme për një mjedis jotoksik;
- d) të kontribuojë për standarde të larta të mirëqenies së kafshëve dhe në veçanti të plotësojë nevojat e veçanta jetësore sipas specieve të kafshëve;
- dh) të nxisë kanalet dhe zinxhirin e shkurtër të shpërndarjes dhe prodhimit lokal në zona të ndryshme të vendit;
- e) të nxisë ruajtjen e racave të rralla dhe autoktone në rrezik zhdukjeje;
- ë) të kontribuojë në zhvillimin e furnizimit të materialit gjenetik bimor të përshtatur ndaj kërkesave dhe objektivave të veçantë të bujqësisë organike;
- f) të kontribuojë dhe të ndihmojë për një nivel të lartë biodiversiteti, në veçanti duke përdorur materiale gjenetike bimore të larmishme, të tilla si material organik heterogjen dhe varietete organike të përshtatshme për prodhimin organik;
- g) të nxisë zhvillimin e aktiviteteve për përmirësimin gjenetik të bimëve që prodhohen sipas metodës së prodhimit organik për të kontribuar për perspektiva ekonomike të favorshme të sektorit organik.

Neni 5

Parimet e përgjithshme të prodhimit organik

Prodhimi organik është një sistem i qëndrueshëm menaxhimi, që bazohet në parimet e përgjithshme si më poshtë:

- a) respektimi i sistemeve dhe cikleve natyrore, ruajtja dhe përmirësimi i gjendjes së tokës, ujit dhe ajrit, shëndetit të bimëve e të kafshëve dhe ekuilibrit midis tyre;

b) ruajtja e elementeve të peizazhit natyror, siç janë zonat ose vendet e trashëgimisë natyrore;

c) përdorimi i përgjegjshëm i energjisë dhe burimeve natyrore, siç janë: uji, toka, lënda organike dhe ajri;

ç) prodhimi i një shumëllojshmërie ushqimi me cilësi të lartë dhe i produkteve të tjera bujqësore e të akuakulturës, që u përgjigjen kërkesave të konsumatorëve për produkte ushqimore, të prodhuara nga procese, të cilat nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin e njeriut, shëndetin e bimëve apo shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve;

d) sigurimi i integritetit të prodhimit organik në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit dhe ushqimit për kafshë;

dh) projektimi dhe menaxhimi i duhur i proceseve organike, bazuar në sistemet ekologjike, si dhe duke përdorur burime natyrore të brendshme të sistemit të menaxhimit me metoda, të cilat:

i. përdorin organizma të gjallë dhe metoda mekanike të prodhimit;

ii. praktikojnë kultivimin e bimëve në tokë dhe prodhimin blegtoral të lidhur me tokën ose akuakulturën, që përputhet me parimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve ujore;

iii. përjashtojnë përdorimin e OMGJ-ve, produkteve të përfutuara nga OMGJ-të dhe produkteve të prodhuara me OMGJ, përveç produkteve mjekësore veterinarë;

iv. bazohen në vlerësimin e riskut dhe, kur është e përshtatshme ose sipas rastit, në përdorimin e masave paraprake dhe masave parandaluese.

e) kufizimi i përdorimit të *input*-eve nga jashtë fermës, kur *input*-et nga jashtë janë të nevojshme ose kur nuk ekzistojnë praktikrat dhe metodat e duhura të menaxhimit, sipas shkronjës “dh” të kësaj pike, *input*-et nga jashtë kufizohen në:

i. *input*-et nga prodhimi organik, ku për materialin riprodhues bimor u jepet përparësi varieteteve të përzgjedhura/seleksionuara për aftësinë e tyre për t’iu përgjigjur nevojave dhe objektivave specifike të bujqësisë organike;

ii. substanca natyrore ose me prejardhje nga substanca natyrore;

iii. plehra minerale me tretshmëri të ulët.

ë) përshtatja e procesit të prodhimit, ku është e nevojshme dhe brenda kuadrit të këtij ligji, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore, ndryshimet rajonale në ekuilibrin ekologjik, kushtet lokale dhe



klimatike, fazat e zhvillimit dhe praktikat e veçanta të mbarështimit të blegtorisë;

f) përjashtimi nga gjithë zinxhiri ushqimor organik i klonimit të kafshëve, i rritjes së kafshëve poliploide të induktuara artificialisht dhe i rrezatimit jonizues;

g) mbajtja e një niveli të lartë të mirëqenies së kafshëve, duke respektuar nevojat e veçanta të specieve.

Neni 6

Parimet e veçanta në aktivitetet bujqësore dhe të akuakulturës

Prodhimi organik në aktivitetet bujqësore dhe të akuakulturës bazohet në parimet e veçanta, si më poshtë:

a) ruajtja dhe rritja e aktivitetit jetësor dhe pjellorisë natyrore të tokës, qëndrueshmërisë së tokës, kapacitetit mbajtës ujqor dhe biodiversitetit të saj, duke parandaluar dhe duke luftuar varfërimin në lëndë organike, ngjeshjen dhe gërryerjen e tokës dhe të ushqyerit të bimëve, kryesisht përmes ekosistemit të tokës;

b) kufizimi në minimum i përdorimit të burimeve të paripërtëritshme dhe *input*-eve të jashtme;

c) riciklimi i mbetjeve dhe i nënprodukteve me origjinë bimore dhe shtazore, si *input*-e për prodhimin bimor dhe shtazor;

ç) mbikëqyrja e shëndetit të bimëve me masa parandaluese, në veçanti zgjedhja e specieve, varieteteve ose e materialit mbjellës dhe shumëzues heterogjen, të qëndrueshëm ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve, qarkullimet e duhura bujqësore, metodat mekanike dhe fizike dhe mbrojtja e armiqve natyrorë të dëmtuesve;

d) përdorimi i farave dhe kafshëve me shkallë të lartë diversiteti gjenetik, qëndrueshmërie ndaj sëmundjeve dhe jetëgjatësisë;

dh) zgjedhja e varieteteve të bimëve, duke mbajtur parasysh veçoritë e çdo sistemi prodhimi organik, duke u përqendruar te rezultatet agronomike, qëndrueshmëria ndaj sëmundjeve, përshtatja ndaj kushteve të ndryshme pedo-klimatike lokale dhe respektimi i pengesave natyrore për kryqëzimet gjenetike;

e) përdorimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik, si material mbjellës dhe shumëzues

bimor organik heterogjen, dhe i varieteteve organike të përshtatshme për prodhim organik;

ë) prodhimi i varieteteve organike, duke shfrytëzuar aftësitë riprodhuese natyrore dhe duke u kushtuar vëmendje pengesave natyrore të kryqëzimit të tyre;

f) mundësia që fermerët të përdorin material mbjellës dhe shumëzues bimor nga fermat e tyre për të shtuar burimet gjenetike, të përshtatura ndaj kushteve të veçanta të prodhimit organik;

g) zgjedhja e racave të kafshëve, duke u mbajtur parasysh shkalla e lartë e diversitetit gjenetik, aftësia e kafshëve për t'iu përshtatur kushteve lokale, aftësia riprodhuese, jetëgjatësia, vitaliteti dhe qëndrueshmëria e tyre ndaj sëmundjeve apo problemeve shëndetësore;

gj) zbatimi i praktikave të prodhimit blegtoral, në përshtatje me terrenin dhe të lidhura me tokën;

h) zbatimi i praktikave zooteknike, të cilat forcojnë sistemin imunitar dhe shtojnë mbrojtjet natyrore kundër sëmundjeve, përfshirë ushtrimet e rregullta fizike dhe qasjen jashtë në natyrë dhe në kullota;

i) ushqyerja e kafshëve me ushqime organike, me përbërës bujqësorë të prodhuar nga prodhimi organik dhe nga substanca natyrore jobujqësore;

j) prodhimi organik blegtoral nga kafshë, të cilat janë rritur në ferma organike gjatë gjithë jetës së tyre, që nga lindja apo kllaçitja;

k) ruajtja e vazhdueshme e mjedisit ujqor të shëndetshëm dhe e cilësisë së ekosistemeve ujqore dhe tokësore përreth;

l) ushqyerja e organizmave ujqorë me ushqime për kafshë nga peshkimi i qëndrueshëm ose me ushqime organike për kafshë me përbërës bujqësorë nga prodhimi organik, përfshirë nga akuakultura organike dhe substanca natyrore jobujqësore;

ll) shmangia e krijimit të ndonjë rreziku për speciet e mbrojtura, që mund të lindë nga prodhimi organik.

Neni 7

Parimet e veçanta në përpunimin e ushqimit organik

Prodhimi i ushqimit organik, i përpunuar, bazohet në parimet e veçanta si më poshtë:

a) prodhimi i ushqimit organik nga përbërës që vijnë nga bujqësia organike;



b) kufizimi i përdorimit të aditivëve ushqimorë, i përbërësve joorganikë, me funksione kryesisht teknologjike e shije, si dhe i mikroelementeve e lëndëve ndihmëse për përpunim, në mënyrë që të përdoren në sasi minimale dhe vetëm në raste nevojë të domosdoshme teknologjike ose për qëllime të veçanta ushqyese;

c) përjashtimi i substancave dhe metodave përpunuese, të cilat mund të keqinformojnë lidhur me natyrën e vërtetë të produktit;

ç) përpunimi me kujdes i ushqimit organik, duke i dhënë përparësi përdorimit të metodave organike, mekanike dhe fizike;

d) përjashtimi i ushqimit, që përmban ose përbëhet nga nanomateriale të prodhuara artificialisht.

Neni 8

Parimet në përpunimin e ushqimit organik për kafshë

Prodhimi i ushqimit organik, i përpunuar për kafshë, bazohet në parimet e veçanta, si më poshtë:

a) prodhimi i ushqimit organik për kafshë nga lëndë e parë për ushqim organik për kafshë;

b) kufizimi i përdorimit të aditivëve dhe lëndëve ndihmëse për përpunimin e ushqimit për kafshë në sasi minimale dhe vetëm në raste nevojë të domosdoshme teknologjike ose zooteknike ose për qëllime të veçanta të të ushqyerit;

c) përjashtimi i substancave dhe i metodave të përpunimit që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të produktit;

ç) përpunimi i ushqimit organik për kafshë, duke iu dhënë përparësi metodave organike, mekanike dhe fizike.

KREU III

RREGULLAT E PRODHIMIT ORGANIK

Neni 9

Rregullat e përgjithshme të prodhimit

1. Operatorët, që përfshihen në prodhimin organik, plotësojnë rregullat e përgjithshme të prodhimit, të përcaktuara në këtë nen.

2. E gjithë ferma menaxhohet në përputhje me kërkesat e këtij ligji, që zbatohen për prodhimin organik.

3. Në prodhimin organik përdoren vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në nenet 21, 22 dhe 23 të këtij ligji, me kusht që përdorimi i tyre në prodhimin joorganik të jetë miratuar sipas legjislacionit në fuqi për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe produktet plehëruese.

4. Në prodhimin organik përdoren edhe produktet dhe substancat e mëposhtme, me kusht që të jenë miratuar sipas legjislacionit në fuqi për produktet për mbrojtjen e bimëve:

a) mbrojtësit, sinergjistët dhe bashkë-formulantët, në përmbajtje të PMB-ve;

b) ndihmësit, të cilët përzihen me PMB-të.

5. Në prodhimin organik bimor lejohet përdorimi i produkteve dhe substancave bujqësore, të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, me kusht që përdorimi i tyre të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në kreun II të këtij ligji.

6. Rrezatimi jonizues nuk përdoret në trajtimin e ushqimeve organike, ushqimeve organike për kafshë dhe lëndëve të para, që përdoren në prodhimin e tyre.

7. Ndalohet përdorimi i klonimit të kafshëve dhe rritja e kafshëve poliploide të indukuara artificialisht.

8. Në çdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes merren masa parandaluese dhe paraprake, kur është e nevojshme, siç përcaktohet në nenin 25 të këtij ligji.

9. Ferma, pavarësisht parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, ndahet në njësi prodhimi të veçara qartësisht dhe efektivisht, për prodhim organik, në kalim dhe joorganik, me kusht që për njësitë e prodhimit joorganik:

a) për kafshët të përdoren specie të ndryshme;

b) për bimët të përdoren varietete të ndryshme dhe lehtësisht të dallueshme.

Këto kërkesa nuk zbatohen për qendrat kërkimore dhe të formimit profesional, fidanishtet bimore, fermat e shumëzimit të farave dhe në përmirësimin gjenetik.

10. Për algat dhe speciet e akuakulturës përfshihen të njëjtat specie, me kusht që të ketë një ndarje të qartë dhe efektive midis proceseve ose njërive të prodhimit.

11. Në përjashtim të shkronjës “b” të pikës 9 të këtij neni, në rastin e kulturave shumëvjeçare, që kërkojnë një periudhë kultivimi prej të paktën 3 vjetësh, mund të përdoren varietete të ndryshme, që nuk dallohen lehtësisht apo të njëjtat varietete, me



kusht që prodhimi në fjalë të përfshihet në një plankalim dhe kalim në prodhim organik të pjesës së fundit të sipërfaqes së prodhimit që të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe të përfundojë maksimumi brenda pesë vjetëve.

12. Në rastet e parashikuara në pikën 9 të këtij neni:

a) fermeri njofton të paktën 48 orë përpara trupën e kontrollit për fillimin e vjeljes së çdo produkti në fjalë;

b) pas përfundimit të vjeljes, fermeri njofton trupën e kontrollit për sasinë faktike të vjela nga njësitë në fjalë dhe masat e marra për veçimin e produkteve;

c) plani i kalimit dhe masat, që duhet të merren për të siguruar veçimin efektiv dhe të dukshëm, konfirmohen çdo vit nga trupa e kontrollit pas fillimit të planit të kalimit.

13. Në rastet e përcaktuara në pikat 9, 10, 11 dhe 12 të këtij neni, kur jo të gjitha njësitë e prodhimit të një ferme menaxhohen sipas rregullave të prodhimit organik, operatorët:

a) mbajnë produktet dhe substancat e përdorura për njësitë e prodhimit organik dhe ato në kalim, të ndara nga ato të përdorura për njësitë e prodhimit joorganik;

b) mbajnë të ndara nga njëra-tjetra produktet e prodhuara në njësitë e prodhimit organik nga ato në kalim dhe joorganik;

c) mbajnë të dhënat e duhura për të treguar ndarjen efektive të njërive të prodhimit dhe të produkteve.

Neni 10

Periudha e kalimit

1. Fermeri dhe operatori, që prodhon alga ose specie të akuakulturës, plotësojnë një periudhë kalimi. Gjatë gjithë periudhës së kalimit zbatohen të gjitha rregullat e prodhimit organik, të përcaktuara në këtë ligj, në veçanti në këtë nen dhe në nenet 13 deri në 18 të këtij ligji.

2. Periudha e kalimit fillon në datën që fermeri ose operatori, i cili prodhon algat apo speciet e akuakulturës, ka regjistruar aktivitetin në përputhje me pikën 1 të nenit 34 të këtij ligji.

3. Asnjë periudhë e mëparshme nuk mund të njihet në mënyrë prapavepruese si pjesë e periudhës së kalimit, përveç rasteve kur:

a) parcelat e tokës së fermerit ose operatorit kanë qenë objekt i masave të përcaktuara në programin e zhvillimit rural për të garantuar se në këto parcela toke nuk janë përdorur produkte apo substanca, përveç atyre që përdoren në prodhimin organik; ose

b) fermeri ose operatori provon se parcelat e tokës kanë qenë zona natyrore ose bujqësore, të cilat për një periudhë, të paktën trevjeçare, nuk kanë qenë trajtuar me produkte apo substanca, që nuk lejohen të përdoren në prodhimin organik.

4. Produktet e prodhuara gjatë periudhës së kalimit nuk tregtohen si produkte organike ose në kalim. Produktet e mëposhtme, të prodhuara gjatë periudhës së kalimit dhe në përputhje me pikën 1 të këtij neni, tregtohen si produkte në kalim vetëm në këto raste:

a) materiali mbjellës dhe shumëzues bimor, me kusht që të jetë plotësuar një periudhë kalimi të paktën 12 muaj;

b) produktet ushqimore dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore, me kusht që këto produkte të përmbajnë vetëm një përbërës bujqësor dhe të jetë plotësuar një periudhë kalimi të paktën 12 muaj përpara korries, vjeljes apo mbledhjes.

5. Dokumentet e veçanta, që paraqiten nga operatori ose grupi i operatorëve dhe procedura për miratimin e njohjes së efekteve prapavepruese të një periudhe të mëparshme kalimi nga KPO-ja miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 11

Ndalimi i përdorimit të OMGJ-ve

1. OMGJ-të dhe produktet e prodhuara nga ose me OMGJ nuk përdoren në produkte ushqimore ose ushqim për kafshë apo si produkt ushqimor, ushqim për kafshë, lëndë ndihmëse në përpunim, produkte për mbrojtjen e bimëve, produkte plehëruese, përmirësues të tokës, material mbjellës dhe shumëzues bimor, mikroorganizma ose kafshë, në prodhimin organik.

2. Për OMGJ-të dhe produktet e prodhuara nga OMGJ-të për ushqim dhe ushqim për kafshë, operatorët bazohen në etiketat apo në dokumentet e tjera shoqëruese të produktit, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin për kafshë.

3. Operatori vlerëson se asnjë OMGJ dhe produkt i prodhuar nga OMGJ-të nuk është përdorur për prodhimin ose përpunimin e produkteve ushqimore dhe ushqimit për kafshë të



blera nëse nuk kanë një etiketë ose dokument shoqërues, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, përveç kur ata kanë dijeni që etiketimi i produkteve në fjalë nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi për ushqimin.

4. Operatori për lëndët ndihmëse në përpunim, produktet për mbrojtjen e bimëve, produktet plehëruese, përmirësuesit e tokës, materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, mikroorganizmat dhe kafshët, kur përdor produkte të tilla joorganike të blera nga palë të tjera, i kërkon shitësit të plotësojë deklaratën se produktet e furnizuara prej tij nuk janë OMGJ dhe nuk janë prodhuar nga ose me OMGJ.

5. Modeli i deklaratës së shitësit miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 12

Kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të materialit organik heterogjen

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i materialit organik heterogjen tregtohet pa plotësuar kërkesat për regjistrim dhe certifikim, sipas kategorive të materialit parabazë, bazë dhe të certifikuar apo kërkesat për t'u vendosur në kategori të tjera, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Furnizuesi paraqet aplikimin *online* për regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik heterogjen nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” në institucionin përgjegjës për farat dhe fidanët. Furnizuesi tregton materialin mbjellës dhe shumëzues bimor organik heterogjen pas regjistrimit të tij.

3. Aplikuesi, përveç informacionit të plotësuar në formularin e aplikimit të kërkesës për regjistrim sipas pikës 2 të këtij neni, duhet të paraqesë brenda 2 ditëve një mostër përfaqësuese në institucionin përgjegjës për farat dhe fidanët.

4. Shqyrtimi i aplikimit për regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik heterogjen sipas pikës 2 të këtij neni kryhet në sistemin elektronik për shërbimet e institucionit përgjegjës për farat dhe fidanët.

5. Institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët e shqyrton aplikimin në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe brenda 2 muajve nga data e marrjes së kërkesës jep vendimin e tij për pranimin e kërkesës dhe kryen regjistrimin në

regjistrin përkatës. Kur kërkesa nuk është paraqitur sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, kërkesit i kërkohet elektronikisht që të korrigjojë pasaktësitë ose mangësitë e konstatuara brenda 7 ditëve. Në këtë rast afati për shqyrtimin e kërkesës fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës së parë për regjistrim. Kur aplikuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda 7 ditëve dhe këto pasaktësi nuk mund të plotësohen nga institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet aplikuesit bashkë me aktet e tjera.

6. Regjistrimi i materialit mbjellës shumëzues bimor heterogjen organik është pa pagesë.

7. Rregullat e hollësishme për prodhimin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor heterogjen organik përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 13

Rregullat për prodhimin organik bimor

1. Operatori që prodhon bimë ose produkte bimore organike, përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit të përcaktuara në nenet 9, 10 dhe 11 të këtij ligji, zbaton edhe rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Kulturat bujqësore organike, përveç atyre që kultivohen natyrisht në ujë, prodhohen në tokë natyrore ose në tokë të plehëruar me produkte dhe substanca të lejuara për përdorim në prodhimin organik, në varësi të përbërjes së tokës dhe shkëmbit amnor.

3. Ndalohet prodhimi hidroponik, i cili është një metodë e kultivimit të bimëve, të cilat nuk rriten në mënyrë natyrore me rrënjët në ujë, por vetëm në një tretësirë ushqyese ose në një mjedis inert, të cilit i shtohet një tretësirë ushqyese.

4. Të gjitha teknikat e prodhimit bimor të përdorura duhet të parandalojnë ose të zvogëlojnë çdo ndotje të mundshme të mjedisit.

5. Për prodhimin e bimëve dhe produkteve organike bimore, përveç materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përdoret vetëm material mbjellës dhe shumëzues bimor organik.

6. Për të prodhuar material mbjellës dhe shumëzues bimor organik, që përdoret për prodhimin e produkteve organike bimore, përjashtuar materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, bima mëmë dhe, ku është e nevojshme, bimë



të tjera që përdoren për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor prodhohen, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, për të paktën një brezni bimore, ose, në rastin e kulturave shumëvjeçare, për të paktën një brezni gjatë dy sezoneve të rritjes.

7. Gjatë zgjedhjes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik, operatori i jep përparësi materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik, të përshtatshëm për bujqësinë organike.

8. Për prodhimin e varieteteve organike, të përshtatshme për prodhimin organik, aktivitetet e përmirësimit gjenetik organik kryhen në kushte organike dhe synojnë rritjen e diversitetit gjenetik, mbështetur në aftësinë natyrore riprodhuese, karakteristikat agronomike, qëndrueshmërinë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe në përshtatjen ndaj kushteve të ndryshme lokale të tokës dhe klimës.

9. Të gjitha praktikatat e shumëzimit, përveç asaj me kultura meristematike, kryhen sipas rregullave të certifikimit organik.

10. Rregullat e hollësishme për prodhimin organik të bimëve dhe produkteve bimore, materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, mbledhjen e bimëve të egra dhe prodhimin e kërpudhave miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 14

Rregullat për prodhimin blegtoral

1. Operatori i prodhimit blegtoral, përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit, të përcaktuara në nenet 9, 10 dhe 11 të këtij ligji, plotëson edhe rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Ndalohet prodhimi blegtoral pa tokë, ku fermeri që synon të prodhojë kafshë organike nuk administron ose disponon tokë bujqësore dhe nuk ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me shkrim me një fermer për përdorimin e njësive të prodhimit organik ose në kalim blegtoral, me përjashtim të rasteve të bletarisë.

3. Rregullat e hollësishme për prodhimin organik blegtoral, përfshirë rregullat për kalimin, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 15

Rregullat e prodhimit për algat dhe specie të akuakulturës

1. Operatori që prodhon alga dhe specie të akuakulturës organike, përveç rregullave të

përgjithshme të prodhimit të përcaktuara në nenet 9, 10 dhe 11 të këtij ligji, plotëson edhe rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Prodhimi kryhet në mjedise që nuk mund të ndoten me produkte ose substanca të palejuara për t'u përdorur në prodhimin organik ose me lëndë ndotëse, që cenojnë natyrën organike të produkteve.

3. Njësitë e prodhimit organik dhe joorganik ndahen në mënyrë të përshtatshme në përputhje me distancat minimale të ndarjes. Masat e tilla të ndarjes bazohen në vendndodhjen natyrore, sistemet e ndara të shpërndarjes së ujit, distancat, rrjedhën e baticës dhe vendndodhjen e sipërme dhe të poshtme të njësive të prodhimit organik.

4. Prodhimi i algave dhe specieve të akuakulturës nuk konsiderohet organik kur kryhet në vende ose zona të papërshtatshme për aktivitete të tilla, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për akuakulturën.

5. Rregullat e hollësishme për prodhimin organik të algave dhe specieve të akuakulturës përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 16

Rregullat e prodhimit të ushqimit të përpunuar organik

1. Operatori që prodhon ushqim të përpunuar organik, përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit, të përcaktuara në nenet 9, 10 dhe 11 të këtij ligji, plotëson edhe rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Përgatitja e produkteve të përpunuara organike, në kalim dhe joorganike kryhen të ndara nga njëra-tjetra në kohë dhe hapësirë. Kur në njësinë e përgatitjes përgatiten ose ruhen produkte organike, në kalim dhe joorganike, operatori:

a) njofton trupën e kontrollit;

b) kryen proceset në vazhdimësi deri në përfundimin e prodhimit të produktit, të ndara në hapësirë dhe në kohë nga proceset e ngjashme që kryhen për produktin tjetër organik, në kalim ose joorganik;

c) ruan produktet organike, në kalim dhe joorganike, para dhe pas proceseve të prodhimit, të ndara nga njëra-tjetra në hapësirë dhe në kohë;

ç) mban një regjistër të përditësuar për të gjitha proceset dhe sasitë e përpunuara;

d) merr masat e nevojshme për të siguruar identifikimin e loteve dhe për të shmangur përzierjet



ose shkëmbimet midis produkteve organike, në kalim dhe joorganike;

dh) kryen proceset e prodhimit të produkteve organike ose në kalim vetëm pas pastrimit të duhur të pajisjeve të prodhimit.

3. Ndalohet të përdoren produkte, substanca e teknika për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit dhe ruajtjes së ushqimit organik, që korrigojnë pakujdesitë gjatë përpunimit apo që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të këtyre produkteve, që tregtohen si ushqime organike.

4. Në prodhimin organik të verës zbatohet legjislacioni në fuqi për vreshtarinë dhe verën, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj dhe produktet e verës prodhohen nga lëndë e parë organike.

5. Në prodhimin e produkteve ushqimore të përpunuara organike nuk përdoren substanca aromatizuese ose preparate aromatizuese, të cilat nuk janë organike apo “natyrale”, sipas legjislacionit në fuqi për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimorë me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore.

6. Rregullat e hollësishme për prodhimin e produkteve ushqimore të përpunuara organike dhe produkteve organike të verës miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 17

Rregullat e prodhimit të ushqimit të përpunuar organik për kafshë

1. Operatori që prodhon ushqim të përpunuar organik për kafshë, përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit të përcaktuara në nenet 9, 10 dhe 11 të këtij ligji, zbaton edhe rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Përgatitja e ushqimit të përpunuar organik për kafshë, në kalim dhe joorganik, kryhet e ndarë në kohë dhe në hapësira të ndryshme. Kur në njësinë e përgatitjes përgatiten ose ruhen ushqime për kafshë të përpunuara organike, në kalim dhe joorganike, operatori:

a) njofton trupën e kontrollit;

b) kryen proceset në vazhdimësi deri në përfundimin e prodhimit, të ndara në hapësirë ose në kohë nga proceset e ngjashme që kryhen për çdo produkt tjetër (organik, në kalim ose joorganik);

c) ruan produktet organike, në kalim dhe joorganike, para dhe pas proceseve të prodhimit, të ndara nga njëra-tjetra në hapësirë dhe në kohë;

ç) mban një regjistër të përditësuar për të gjitha proceset e prodhimit dhe sasitë e përpunuara;

d) merr masat e nevojshme për të siguruar identifikimin e loteve dhe për të shmangur përzierjet ose shkëmbimet midis produkteve organike, në kalim dhe joorganike;

dh) kryen proceset e prodhimit të produkteve organike ose në kalim, pas pastrimit të duhur të pajisjeve të prodhimit.

3. Rregullat e hollësishme për prodhimin e ushqimit të përpunuar organik për kafshë miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 18

Rregullat për prodhimin e majave organike

1. Operatori, i cili prodhon maja për t'u përdorur si ushqim ose ushqim për kafshë, përveç rregullave të prodhimit të përcaktuara në nenet 9, 11, 16 dhe 17 të këtij ligji, zbaton edhe rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Për prodhimin e majave organike përdoren vetëm substrate të prodhuara me metoda organike.

3. Majaja organike nuk duhet të jetë e pranishme së bashku me majanë joorganike në ushqimin organik ose në ushqimin organik për kafshë.

4. Rregullat e hollësishme për prodhimin e majave organike, që përdoren si ushqim ose ushqim për kafshë, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 19

Rregullat përjashtuese në prodhimin organik

1. Në rastet e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, që diktojnë një gjendje të jashtëzakonshme dhe që e bëjnë të pamundur përmbushjen e rregullave të prodhimit organik, mund të lejohen përjashtime nga rregullat e prodhimit për një periudhë kohe të kufizuar derisa prodhimi organik të mund të rikthehet në kushte normale, duke zbatuar parimet e përcaktuara në kreun II të këtij ligji, si dhe parashikimet e këtij neni.

2. Pas shpalljes zyrtare të gjendjes së jashtëzakonshme, si pasojë e “motit të keq”, “sëmundjes së kafshëve”, “incidentit mjedisor”, “fatkeqësisë natyrore” ose të çdo situatë tjetër të



ngjashme, KPO-ja, kryesisht me identifikimin e operatorëve të prekur në zonën e shpallur ose me kërkesë nga një operator ose grup operatorësh në zonën e shpallur, vendos miratimin e përjashtimeve nga rregullat e prodhimit organik dhe kriteret që lidhen me to, me kusht që këto përjashtime dhe kriteret të zbatohen:

a) për një periudhë të kufizuar, por jo më shumë sesa është e nevojshme, dhe në asnjë rast më shumë se 12 muaj për të vazhduar ose rifilluar prodhimin organik, siç është kryer përpara datës së zbatimit të këtyre përjashtimeve;

b) në lidhje me llojet specifike të prodhimit të prekura ose, sipas rastit, parcelat e tokës; dhe

c) për të gjithë operatorët organikë përkatës, të prekur në zonën e shpallur ose vetëm për operatorin ose grupin e operatorëve, sipas rastit.

3. Operatori ose grupi i operatorëve paraqet aplikimin *online* për miratimin e përjashtimeve nga rregullat e prodhimit organik, sipas pikës 2 të këtij neni, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë.

4. Zbatimi i përjashtimeve nuk prek vlefshmërinë e certifikatës zyrtare gjatë periudhës kur zbatohen përjashtimet, me kusht që operatori ose grupi i operatorëve në fjalë të plotësojë kriteret në të cilat janë dhënë përjashtimet.

5. Përjashtime të veçanta nga rregullat e prodhimit organik, që miratohen në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme dhe procedurat e miratimit të aplikimeve për përjashtim miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 20

Grumbullimi, ambalazhimi, transporti dhe ruajtja

1. Operatori siguron që produktet organike dhe në kalim grumbullohen, ambalazhohen, transportohen dhe ruhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Operatori mund të kryejë njëkohësisht grumbullimin e produkteve organike, në kalim dhe joorganike, vetëm kur merren masa për të parandaluar çdo përzjerje ose shkëmbim të mundshëm midis tyre dhe për të siguruar identifikimin e produkteve organike dhe në kalim.

3. Operatori regjistron të dhënat për ditët, orët e mbledhjes, lëvizjet, datën dhe orën e magazinimit të produkteve për t’ia vënë në dispozicion trupës së kontrollit ose autoritetit përkatës të kontrollit zyrtar.

4. Rregullat e hollësishme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve organike përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 21

Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik

1. Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik përdoren për qëllimet e mëposhtme:

a) si lëndë vepruese në përmbajtje të produkteve për mbrojtjen e bimëve;

b) si plehërues, përmirësues të tokës dhe lëndë ushqyese, në përmbajtje të produkteve plehëruese;

c) si lëndë e parë për ushqime joorganike për kafshë me origjinë bimore, shtazore, nga algat ose majatë apo si lëndë e parë për ushqime për kafshë, me origjinë mikrobike apo minerale;

ç) si produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e pellgjeve, kafazeve, depozitave, kanaleve ujore, ndërtesave ose impianteve, që përdoren për prodhimin organik blegtoral;

d) si produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe impianteve, që përdoren për prodhimin bimor, përfshirë ruajtjen në një fermë bujqësore;

dh) si produkte për pastrim dhe dezinfektim në stabilimentet e përpunimit dhe ruajtjes.

2. Produktet dhe substancat, që përdoren në prodhimin organik, u nënshtrohen parimeve të përcaktuara në kreun II të këtij ligji, dhe në mënyrë kumulative duhet që:

a) përdorimi i tyre të jetë thelbësor për një prodhim të qëndrueshëm dhe për çfarë synohet të përdoret;

b) këto produkte dhe substanca të jenë me origjinë bimore, algash, shtazore, mikrobike ose minerale, përveçse kur ato nuk gjenden në sasi të mjaftueshme ose cilësinë e duhur, si dhe nuk gjenden alternativa të tjera nga burime të tilla;

c) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni:

i. përdorimi i tyre është i domosdoshëm për kontrollin e dëmtuesve, për të cilin nuk ka alternativa të tjera biologjike, fizike ose nga përmirësimi gjenetik i bimëve, praktika kultivimi ose praktika të tjera menaxhimi të efektshme;



ii. nëse produktet e tilla nuk janë me origjinë bimore, algash, shtazore, mikrobike ose minerale dhe nuk janë identike me formën e tyre natyrore, parakusht për përdorimin e tyre është përjashtimi i çdo kontakti të drejtpërdrejtë me pjesët e ngrënshme të bimës.

ç) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, përdorimi i tyre është i domosdoshëm për të rritur, ruajtur pjellorinë e tokës, duke përbushur kërkesat e veçanta të të ushqyerit të bimëve ose për qëllime të veçanta për përmirësimin e tokës;

d) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni zbatohen këto rregulla:

i. përdorimi i tyre është i nevojshëm për ruajtjen e shëndetit, mirëqenies dhe vitalitetit të kafshëve dhe kontribuon për një dietë të përshtatshme, që plotëson nevojat fiziologjike dhe të sjelljes së specieve në fjalë, ose në rast se këto ushqime për kafshë nuk mund të prodhohen apo të ruhen pa përdorimin e këtyre substancave;

ii. ushqimi për kafshë me origjinë minerale, oligoelementet, vitaminat ose provitaminat të jenë me origjinë natyrale, përveç rasteve kur produktet ose substancat nga këto burime nuk gjenden në sasi të mjaftueshme ose me cilësinë e duhur ose nuk ka alternativa të tjera;

iii. përdorimi i lëndëve të para për ushqim për kafshë joorganik, me origjinë bimore ose shtazore, është i nevojshëm, sepse lëndët e para për ushqim për kafshë me origjinë bimore ose shtazore, të prodhuara në përputhje me rregullat e prodhimit organik, nuk gjenden në sasi të mjaftueshme;

iv. përdorimi i erëzave, bimëve aromatike dhe melasës joorganike është i nevojshëm, sepse produkte të tilla nuk gjenden në formë organike, por ato duhet të prodhohen ose të përgatiten pa tretës kimikë dhe përdorimi i tyre kufizohet në 1% të racionit ushqimor për një specie të caktuar, llogaritur çdo vit si përqindje e lëndës së thatë të ushqimit për kafshë me origjinë bujqësore.

3. Produktet dhe substancat e sintetizuara kimikisht në përputhje me pikën 1 të këtij neni dhe me pikën 1 të nenit 22 të këtij ligji përdoren në mënyrë shumë të kufizuar në rastet kur përdorimi i *input*-eve të jashtme, të përmendura në shkronjën “e” të nenit 5 të këtij ligji, shkakton ndikime të dëmshme në mjedis.

4. Lista e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin organik, sipas pikës 1 të këtij neni, miratohet me urdhër të ministrit dhe përditësohet rregullisht.

5. Në prodhimin organik përdoren vetëm PMB-të dhe produktet plehëruese, të cilat kanë në përmbajtje të tyre produktet dhe substancat e miratuara sipas pikës 4 të këtij neni.

6. PMB-të dhe produktet plehëruese, që përdoren në prodhimin organik, miratohen sipas procedurave të legjislacionit për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe të produkteve plehëruese. Në etiketën e PMB-së dhe të produkteve plehëruese të miratuar shtohet shënimi “për përdorim edhe në prodhimin organik”.

7. Lista e PMB-ve dhe produkteve plehëruese, që përdoren në prodhimin organik, publikohet nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve dhe për produktet plehëruese në ministri, në faqen zyrtare të ministrisë.

Neni 22

Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, të përpunuar dhe majave

1. Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin e produkteve ushqimore organike, të përpunuara dhe majave që përdoren si ushqim ose ushqim për kafshë, përdoren për qëllimet si më poshtë:

- a) si aditivë ushqimorë, aditivë të ushqimit për kafshë dhe lëndë ndihmëse për përpunimin;
- b) si përbërës bujqësorë joorganikë për prodhimin e ushqimeve organike të përpunuara;
- c) si lëndë ndihmëse përpunimi për prodhimin e majave dhe produkteve të tyre.

2. Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin e ushqimit organik dhe ushqimit të përpunuar për kafshë ose për prodhimin e majave, që përdoren si ushqim ose ushqim për kafshë, u nënshtrohen parimeve të përcaktuara në kreun II të këtij ligji dhe përdoren vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) nëse nuk gjenden produkte apo substanca alternative, të përcaktuara në përputhje me këtë nen ose teknologji në përputhje me këtë ligji;
- b) nëse pa përdorimin e tyre është e pamundur të prodhohen ose të ruhen ushqime ose ushqime për



kafshë ose të plotësohen kërkesat e caktuara dietike, të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi;

c) këto produkte dhe substanca gjenden në natyrë dhe u nënshtrohen vetëm proceseve mekanike, fizike, biologjike, enzimatike ose mikrobike, me përjashtim të rasteve kur produktet ose substancat nga këto burime nuk gjenden në sasi të mjaftueshme ose me cilësinë e duhur;

ç) kur përbërësi organik nuk gjendet në sasi të mjaftueshme.

3. Lista e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, organik, të përpunuar dhe të majave që përdoren si ushqim ose ushqim për kafshë, sipas pikës 1 të këtij neni, miratohet me urdhër të ministrit dhe rishikohet të paktën një herë në vit.

Neni 23

Përdorimi i përbërësve bujqësorë joorganikë për ushqimet organike të përpunuara

1. Për të siguruar përbërës të caktuar bujqësorë, që nuk gjenden në formë organike në sasi të mjaftueshme, dhe që janë miratuar për përdorim të përkohshëm nga të paktën një vend anëtar i Bashkimit Evropian, Komisioni për Prodhimin Organik, me kërkesë të operatorit, miraton përkohësisht përdorimin e përbërësve bujqësorë joorganikë për prodhimin e ushqimit organik të përpunuar, për një periudhë deri në gjashtë muaj. Ky miratim zbatohet për të gjithë operatorët në Shqipëri.

2. Operatori vërteton se përbërësit nuk gjenden në formë organike në sasi të mjaftueshme, duke paraqitur të paktën dy përgjigje negative nga furnizuesi, ku deklarohet se përbërësi nuk gjendet në formë organike ose që sasia ekzistuese nuk është e mjaftueshme për nevojat e operatorëve.

3. KPO-ja, me kërkesë të operatorit, zgjat miratimin deri në dy herë për maksimumi gjashtë muaj secila, me kusht që këta përbërës vazhdojnë të mos gjenden në formë organike në sasi të mjaftueshme.

4. Nëse edhe pas zgjatjes së dytë, përbërës të tillë nuk gjenden në formë organike dhe në sasi të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e operatorëve, këta përbërës përdoren vetëm nëse miratohen sipas pikës 3 të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 24

Mbledhja e të dhënave për gjendjen në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik dhe në kalim, kafshëve organike dhe rasatit organik të peshqve në akuakulturë

1. Aplikimi për vetëdeklarimin e gjendjes për tregtim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, kafshëve organike ose rasat peshku organik në akuakulturë bëhet *online* në portalin qeveritar “e-Albania” dhe është pa pagesë. Ky aplikim shoqërohet me certifikatën e operatorit organik që ka prodhuar këto produkte.

2. Të dhënat e vetëdeklarimit të gjendjes, sipas pikës 1 të këtij neni, postohen në sistemin elektronik për shërbimet e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, që lejon operatorët, të cilët tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, kafshëve organike ose rasat peshku organik në akuakulturë dhe që janë në gjendje t’i furnizojnë ato në sasi të mjaftueshme dhe brenda një kohe të arsyeshme të bëjnë publike në bazë vullnetare, bashkë me emrat dhe të dhënat e tyre, informacionet për:

a) materialin mbjellës dhe shumëzues bimor organik dhe në kalim, si p.sh. materialin mbjellës dhe shumëzues bimor organik heterogjen ose varietetet organike, të përshtatshme për prodhim organik, duke përfshirë fidanët, përfshirë patatet për farë, të cilat janë të disponueshme, sasinë dhe peshën e atij materiali, periudhën e disponueshmërisë së tij gjatë vitit. Këto materiale vendosen në listë të paktën me emrin shkencor latinisht;

b) kafshët organike për të cilat lejohen përjashtime në përputhje me pikën 3 të nenit 14 të këtij ligji, numrin e kafshëve të disponueshme të ndara sipas gjinisë, informacionin për speciet e ndryshme të kafshëve, për racat dhe llojet që disponohen, racat dhe moshën e kafshëve dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm për to;

c) rasatin organik të peshkut në akuakulturë, të disponueshme në fermë dhe statusin e tyre shëndetësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin e kafshëve dhe kapacitetin prodhues për çdo specie akuakulture.

3. Operatorët që vendosin të përfshijnë informacione për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, kafshët ose rasatin e peshkut në akuakulturë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni,



sigurojnë përditësimin e rregullt të këtij informacioni.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimet nga rregullat e prodhimit, sipas pikës 3 të nenit 14 dhe të pikës 5 të nenit 15 të këtij ligji, dhe verifikon nëse kafshët ose rasati i peshkut për të cilat kërkohen përjashtime nuk përfshihen në listën sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni.

5. Trupa e kontrollit miraton përjashtimet për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik pas verifikimit nëse nuk përfshihet në listën sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni.

6. Format i vetëdeklarimit, sipas pikës 2 të këtij neni, dhe formatet e aplikimit për miratimin e përjashtimeve, sipas pikës 4 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 25

Detyrimet dhe veprimet në rast dyshimi për mospërputhje

Një operator, kur dyshon se një produkt i prodhuar, i përgatitur ose i importuar prej tij ose i pranuar nga një operator tjetër, nuk është në përputhje me këtë ligj, ai në përputhje me pikën 2 të nenit 26:

- a) identifikon dhe veçon produktin në fjalë;
- b) verifikon nëse dyshimi mund të vërtetohet sipas procedurës së përcaktuar në pikën 6 të nenit 27 të këtij ligji;
- c) nuk e vendos në treg produktin në fjalë si produkt organik ose në kalim dhe nuk e përdor në prodhimin organik, përveç rastit kur dyshimi eliminohet;
- ç) njofton menjëherë trupën e kontrollit dhe i jep të dhënat që disponon, kur dyshimi për mospërputhje është vërtetuar ose kur nuk eliminohet;
- d) bashkëpunon plotësisht me trupën e kontrollit ose autoritetin kompetent përkatës të kontrollit zyrtar për të verifikuar dhe për të identifikuar arsyet e mospërputhjes së dyshuar.

Neni 26

Masat paraprake për shmangien e produkteve dhe substancave të palejuara

1. Operatori për të shmangur ndotjen me produkte ose substanca, të cilat nuk lejohen të

përdoren në prodhimin organik, merr masa paraprake në çdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes:

a) duke vendosur dhe duke zbatuar masa për të identifikuar rreziqet për ndotjen e prodhimit dhe produkteve organike me produkte ose substanca të palejuara, përfshirë identifikimin sistematik të hapave proceduralë kritikë;

b) duke vendosur dhe duke zbatuar masa për të shmangur rrezikun e ndotjes së prodhimit dhe produkteve organike, me produkte ose substanca të palejuara;

c) duke rishikuar dhe duke përshtatur rregullisht këto masa; dhe

ç) duke plotësuar kërkesat e tjera përkatëse të këtij ligji, të cilat garantojnë veçimin e produkteve organike, në kalim dhe joorganike.

2. Kur operatori dyshon për praninë e produkteve ose substancave të palejuara në prodhimin organik, në një produkt ushqimor, që përdoret ose tregtohet si organik ose në kalim:

- a) identifikon dhe veçon produktin në fjalë;
- b) kontrollon nëse dyshimi vërtetohet sipas procedurës së përcaktuar në pikën 6 të nenit 27 të këtij ligji;
- c) nuk e vendos në treg produktin në fjalë, si produkt organik ose në kalim, dhe nuk e përdor atë në prodhimin organik, përveç kur dyshimi eliminohet;
- ç) kur dyshimi është vërtetuar ose nuk eliminohet, njofton menjëherë trupën e kontrollit dhe i jep të dhënat që disponon kur kërkohen;
- d) bashkëpunon me trupën e kontrollit ose autoritetin kompetent përkatës të kontrollit zyrtar për të identifikuar dhe për të verifikuar arsyet e pranisë së produkteve ose substancave të palejuara.

Neni 27

Masat e marra në rast të pranisë së produkteve ose substancave të palejuara

1. Kur trupa e kontrollit merr informacion të vërtetuar për praninë e produkteve ose substancave të palejuara në prodhimin organik ose është njoftuar nga një operator në përputhje me shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 26 të këtij ligji, ose zbulon produkte ose substanca të tilla në një produkt organik ose në kalim:

a) kryen menjëherë një hetim zyrtar për të përcaktuar burimin dhe shkakun e pranisë së tyre



brenda një periudhe të caktuar, duke marrë parasysh jetëgjatësinë e produktit dhe kompleksitetin e rastit;

b) në pritje të rezultateve të hetimit zyrtar ndalon përkohësisht vendosjen në treg të këtyre produkteve organike ose në kalim dhe përdorimin e tyre në prodhimin organik.

2. Produkti në fjalë ndalohet të tregtohet si produkt organik ose në kalim dhe ndalohet të përdoret në prodhimin organik nëse trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar, që kryen hetimin zyrtar, ka përcaktuar se operatori:

a) ka përdorur produkte ose substanca të palejuara për t'u përdorur në prodhimin organik në përputhje me pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 9 të këtij ligji;

b) nuk ka marrë masat paraprake të përcaktuara në pikën 1 të nenit 26 të këtij ligji;

c) nuk ka marrë masa në zbatim të kërkesave të mëparshme përkatëse nga trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar.

3. Operatorit në fjalë i jepet mundësia për të komentuar rezultatet e hetimit zyrtar të kryer.

4. Trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar, sipas rastit, mban të dhëna dhe shënime të dokumentuara për hetimin zyrtar të kryer.

5. Operatori merr masat korrigjuese të nevojshme për të shmangur ndotjet në të ardhmen.

6. Procedura që ndiqet nga operatori në rast dyshimi për mospërputhje nga prania e produkteve ose substancave të palejuara dhe metodologjia për kryerjen e hetimit zyrtar nga trupa e kontrollit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV ETIKETIMI

Neni 28

Përdorimi i termave që i referohen prodhimit organik

1. Termat “organik”, “biologjik” ose “ekologjik” dhe shkurtimet, si “bio” ose “eko” kanë të njëjtin kuptim dhe përdoren të vetme ose të kombinuara në etiketim, reklamim ose dokumentet tregtare të produkteve, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji, nëse produkti, përbërësit e tij ose lëndët e para të ushqimit për kafshë të përdorura për prodhimin e tij janë prodhuar në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

2. Për produktet e përcaktuara në fushën e këtij ligji, termat që i referohen prodhimit organik nuk përdoren për etiketimin, reklamimin ose në dokumentet tregtare të një produkti, i cili nuk është në përputhje me këtë ligj.

3. Termat që i referohen prodhimit organik nuk mund të përdoren si markë tregtare, emra të kompanisë, njësi të shitjes ose praktika të tjera të përdorura në etiketim ose reklamim, që mund të keqinformojnë ose të mashtrjnë konsumatorin ose përdoruesin, duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Produktet e prodhuara gjatë periudhës së kalimit nuk etiketohen ose reklamohen si produkte organike ose në kalim. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor, produktet ushqimore me origjinë bimore dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore, të prodhuara gjatë periudhës së kalimit, mund të etiketohen dhe të reklamohen si produkte në kalim, duke përdorur termin “në kalim” bashkë me termat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Termat e përcaktuar në pikat 1 dhe 4 të këtij neni nuk përdoren për një produkt për të cilin në etiketim ose reklamim tregohet se produkti përmban OMGJ, përbëhet nga OMGJ-të ose është prodhuar nga OMGJ-të.

Neni 29

Etiketimi i produkteve në kalim

1. Treguesit e përcaktuar në pikën 4 të nenit 28 të këtij ligji për produktet në kalim, me origjinë bimore, paraqiten:

a) me ngjyrë, madhësi dhe shkrim të tillë, që të mos jenë më të dukshëm se përshkrimi i shitjes së produktit dhe të gjithë treguesit të kenë të njëjtën madhësi shkrimi;

b) në të njëjtën fushëpamje me numrin e kodit të trupës së kontrollit, siç përcaktohet në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji.

2. Treguesi i numrit të kodit të trupës së kontrollit paraqitet në të njëjtën fushëpamje me logon kombëtare të prodhimit organik kur përdoret në etiketim.

3. Treguesi i vendit ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore, nga të cilat përbëhet produkti, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, vendoset poshtë numrit të kodit të trupës së kontrollit.



Neni 30

Etiketimi i ushqimeve organike të përpunuara

1. Për ushqimin e përpunuar, termat që i referohen metodës organike të prodhimit, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 28 të këtij ligji përdoren:

a) në përshkrimin e shitjes dhe në listën e përbërësve, kur një listë e tillë është e detyrueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit, me kusht që:

i. ushqimet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, në veçanti me kërkesat e pikës 6 të nenit 16 të këtij ligji;

ii. të paktën 95% e peshës së përbërësve bujqësorë të produktit të jenë organikë; dhe

iii. sa u përket aromatizuesve, ato përdoren vetëm për substanca dhe preparate natyrale aromatizuese, të etiketuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për aromatizuesit dhe të gjithë përbërësit aromatizues dhe bartësit e përbërësve aromatizues në aromatizuesin në fjalë të jenë organikë.

b) vetëm në listën e përbërësve, me kusht që:

i. më pak se 95% e peshës së përbërësve bujqësorë të produktit të jenë organikë dhe këta përbërës të jenë në përputhje me rregullat e prodhimit të përcaktuara në këtë ligj; dhe

ii. ushqimet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e prodhimit të përcaktuara në këtë ligj, në veçanti me kërkesat e pikës 6 të nenit 16 të këtij ligji, me përjashtim të rregullave për përdorimin e kufizuar të përbërësve bujqësorë joorganikë.

c) në përshkrimin e shitjes dhe në listën e përbërësve, me kusht që:

i. përbërësi kryesor të jetë një produkt gjuetie ose peshkimi;

ii. termat që i referohen prodhimit organik, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 28 të këtij ligji, të lidhen qartë me një përbërës tjetër organik dhe të ndryshëm nga përbërësi kryesor;

iii. të gjithë përbërësit e tjerë bujqësorë të jenë organikë;

iv. ushqimet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e prodhimit të përcaktuara në pikën 2 të nenit 16 të këtij ligji, dhe në veçanti në pikën 6 të nenit 16 të këtij ligji, me përjashtim të rregullave për

përdorimin e kufizuar të përbërësve bujqësorë joorganikë.

2. Lista e përbërësve, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, tregon se cilët përbërës janë organikë. Referencat për prodhimin organik vendosen vetëm për përbërësit organikë.

3. Lista e përbërësve të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni përfshin një tregues të përqindjes totale të përbërësve organikë, në raport me sasinë totale të përbërësve bujqësorë.

4. Termat që i referohen metodës organike të prodhimit, kur përdoren në listën e përbërësve të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, dhe treguesi i përqindjes së përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, vendosen me ngjyrë, madhësi dhe shkrim të njëjtë me treguesit e tjerë në listën e përbërësve.

5. Për ushqimet e përpunuara për kafshë, termat që i referohen metodës së prodhimit organik përdoren në përshkrimin e shitjes dhe në listën e përbërësve, me kusht që:

a) ushqimi i përpunuar për kafshë të jetë në përputhje me rregullat e prodhimit të përcaktuara në nenet 14, 15 dhe në pikën 3 të nenit 17 të këtij ligji;

b) të gjithë përbërësit me origjinë bujqësore, që përmbahen në ushqimin e përpunuar për kafshë, të jenë organikë;

c) të paktën 95% e lëndës së thatë të produktit të jetë organik.

Neni 31

Etiketimi i produkteve dhe i substancave që përdoren në prodhimin bimor

Pavarësisht nga fusha e këtij ligji, produktet dhe substancat e përdorura në produktet për mbrojtjen e bimëve ose produktet plehëruese, përmirësues të tokës ose lëndë ushqyese, të miratuara për t'u përdorur në prodhimin organik, në përputhje me nenet 9 dhe 21 të këtij ligji, mund të mbartin një referencë që tregon që janë të lejuara të përdoren për prodhimin organik në përputhje me këtë ligj.

Neni 32

Treguesit e detyrueshëm

1. Kur produktet mbartin termat që i referohen metodës organike të prodhimit, përfshirë produktet e etiketuara si produkte në kalim, duhet që:



a) në etiketim të vendoset emri dhe numri i kodit të trupës së kontrollit, subjekt i së cilës ka qenë operatori që ka kryer veprimin, procesin e fundit të prodhimit ose përgatitjes;

b) në ambalazhin e ushqimit të paraambalazhuar vendoset dukshëm logoja kombëtare e prodhimit organik, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 4 të nenit 28 të këtij ligji dhe në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 30 të këtij ligji.

2. Kur vendoset logoja kombëtare për prodhimin organik, në të njëjtën fushëpamje me të vendoset një tregues i vendit ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore nga të cilat përbëhet produkti dhe, sipas rastit, në një nga format e mëposhtme:

a) “Bujqësi shqiptare”, kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në Shqipëri;

b) “Bujqësi joshqiptare”, kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në vende të tjera;

c) “Bujqësi shqiptare/joshqiptare”, kur një pjesë e lëndëve të para bujqësore është kultivuar në Shqipëri dhe pjesa tjetër në një vend tjetër.

3. Treguesi “Bujqësi” mund të zëvendësohet me “Akuakulturë” dhe treguesit “Shqiptare” dhe “Joshqiptare” mund të zëvendësohen ose të plotësohen me emrin e rajonit ose vendit në rastin kur të gjitha lëndët e para bujqësore nga të cilat përbëhet produkti janë kultivuar në atë rajon apo vend.

4. Për të treguar vendin ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore nga të cilat përbëhet produkti, nuk merren parasysh sasi të vogla në peshë të përbërësve, kur sasia e përgjithshme e këtyre përbërësve nuk kalon 5% të sasisë së përgjithshme në peshë të lëndëve të para me origjinë bujqësore.

5. Treguesi “Shqiptar” ose “Joshqiptar” nuk duhet të paraqitet me shkronja me ngjyrë, madhësi dhe stil, që e bëjnë më të dukshëm se përshkrimi për shitje i produktit.

6. Treguesit e detyrueshëm dhe logoja kombëtare kur përdoren vendosen në një vend të dukshëm, lehtësisht dhe qartësisht të lexueshëm dhe të mos fshihen.

Neni 33

Logoja kombëtare e prodhimit organik

1. Logoja kombëtare e prodhimit organik përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të prodhuara në vend, të cilat plotësojnë

kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe që vendosen në tregun shqiptar.

2. Logoja kombëtare e prodhimit organik mund të përdoret edhe për qëllime informimi dhe edukimi lidhur me ekzistencën dhe reklamimin e vetë logos, me kusht që një përdorim i tillë të mos keqinformojë konsumatorin lidhur me prodhimin organik të produkteve të veçanta që përdoren gjatë informimit dhe me kusht që logoja të riprodhohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 7 të këtij neni. Në këto raste nuk zbatohen kërkesat e pikës 2 të nenit 32 të këtij ligji.

3. Logoja kombëtare e prodhimit organik nuk përdoret për produktet organike të përpunuara, të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 30 të këtij ligji, dhe produktet në kalim.

4. Përdorimi i logos shqiptare të prodhimit organik është vullnetare për produktet e importuara nga shtetet anëtare të BE-së, si dhe nga vendet e treta. Kur kjo logo vendoset në etiketimin e produkteve të tilla, treguesi i vendit ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore nga të cilat përbëhet produkti vendoset në etiketim.

5. Në etiketimin, paraqitjen dhe reklamën e produkteve organike mund të përdoren edhe logo të tjera private në përputhje me këtë ligj.

6. Logoja evropiane për prodhimin organik mund të përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të importuara, të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në kreun VII të këtij ligji.

7. Rregullat e hollësishme për përbërjen, paraqitjen, madhësinë dhe dizejnimin e logos kombëtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V CERTIFIKIMI

Neni 34

Regjistrimi i aktivitetit

1. Përpara vendosjes në treg të çdo produkti organik, në kalim ose para periudhës së kalimit, operatori dhe grupi i operatorëve, të cilët prodhojnë, përgatisin, shpërndajnë ose ruajnë produkte organike ose në kalim, që importojnë ose eksportojnë apo vendosin në treg produkte të tilla, regjistrojnë aktivitetin e tyre në autoritetin



kompetent, sipas fushës përkatëse për kontrollin zyrtar.

2. Aplikimi për regjistrimin e aktivitetit, sipas pikës 1 të këtij neni, paraqitet *online* nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”.

3. Operatori ose grupi i operatorëve përcakton në aplikimin për regjistrim trupën e kontrollit që do të verifikojë nëse aktiviteti i tij është në përputhje me këtë ligj dhe që e pajis me certifikatë zyrtare.

4. Operatori që shet produkte organike të paraambalazuara direkt te konsumatori ose përdoruesi i fundit, përjashtohet nga detyrimi për regjistrim dhe për t’u pajisur me certifikatë zyrtare, me kusht që të mos:

a) prodhojë, përgatisë, ruajë, përveç rasteve të ruajtjes së këtyre produkteve të ambalazuara në pikën e shitjes;

b) importojë produkte të tilla;

c) nënkontraktujë aktivitete të tilla te një operator tjetër.

5. Operatori, grupi i operatorëve dhe nënkontraktorët mbajnë të dhëna për aktivitetet që kryejnë në përputhje me këtë ligj.

Neni 35

Nënkontraktimi i aktivitetit te palët e treta

1. Operatori ose grupi i operatorëve mund të nënkontraktujë një nga aktivitetet e tyre te palët e treta.

2. Operatori ose grupi i operatorëve dhe nënkontraktuesit duhet të regjistrojnë aktivitetin, përveç rastit kur operatori ose grupi i operatorëve kanë deklaruar në kërkesën për regjistrim se mbajnë përgjegjësi për prodhimin organik dhe nuk ia kanë transferuar nënkontraktuesit.

3. Trupa e kontrollit verifikon nëse aktivitetet e nënkontraktuara janë në përputhje me këtë ligj, në kuadër të kontrollit që kryen tek operatori ose grupi i operatorëve, të cilët kanë nënkontraktuar aktivitetet e tyre.

Neni 36

Menaxhimi i procesit të regjistrimit

1. Autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar pranon aplikimet e paraqitura *online* në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe menaxhon procesin e regjistrimit të aktivitetit.

2. Autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar mban bazën e të dhënave të operatorëve ose grup-operatorëve, që kanë regjistruar aktivitetin e tyre të përditësuar. Autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar publikon listën e përditësuar me emrin dhe adresën e operatorit ose grup-operatorëve që kanë regjistruar aktivitetin e tyre bashkë me informacionin për certifikatat zyrtare të lëshuara në faqen zyrtare. Publikimi i këtyre të dhënave kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar siguron që çdo operator apo grup-operatorësh, të cilët përmbushin kërkesat e këtij ligji dhe që paguajnë një tarifë të arsyeshme, që mbulon koston e kontroleve për certifikim, të përfshihet në sistemin organik të kontrollit.

4. Autoriteti kompetent përkatës i mbikëqyrjes, përcaktuar në pikën 1 të nenit 47 të këtij ligji, siguron që çdo trupë kontrolli publikon dhe përditëson në faqen e saj zyrtare tarifat për inspektimin dhe certifikimin e operatorëve dhe grup-operatorëve në sistemin e tyre të kontrollit.

5. Autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar siguron që ministria dhe agjencia përgjegjëse për zhvillim bujqësor dhe rural të gjenerojnë informacione të përditësuara për operatorët ose grup-operatorët, që kanë regjistruar aktivitetin e tyre sipas pikës 2 të këtij neni, nga sistemet elektronike të shërbimeve të tyre.

6. Procedura dhe formati i aplikimit për regjistrimin e aktivitetit të operatorit ose grup-operatorit, sipas nenit 34 të këtij ligji, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 37

Pajisja me certifikatë zyrtare

1. Trupat e kontrollit pajisin me certifikatë zyrtare çdo operator ose grup-operatorësh që kanë regjistruar aktivitetin e tyre dhe janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Certifikata zyrtare:

a) lëshohet në format elektronik;

b) identifikon operatorin ose grupin e operatorëve, duke përfshirë listën e anëtarëve, kategorinë e produkteve që mbulon certifikata dhe periudhën e vlefshmërisë së saj;



c) vërteton që operatori ose grup-operatori, që ka regjistruar aktivitetin e tij është në përputhje me këtë ligj;

ç) lëshohet në përputhje me modelin e përcaktuar në këtë nen.

3. Operatori dhe grupi i operatorëve, pa prekur parashikimin në pikën 4 të nenit 34 të këtij ligji, nuk vendos në treg produktet e fushës së zbatimit të këtij ligji, si produkte organike ose produkte në kalim, pa e regjistruar aktivitetin dhe pa u pajisur me certifikatë zyrtare.

4. Një operator ose grup-operatorësh nuk ka të drejtë të pajiset me certifikatë nga më shumë se një trupë kontrolli për aktivitetet e kryera lidhur me të njëjtën kategori produktesh, përfshirë rastet kur operatori ose grupi i operatorëve kryejnë aktivitete në faza të ndryshme të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.

5. Anëtarët e një grupi operatorësh nuk pajisen me certifikatë individuale për asnjë nga aktivitetet që mbulohen nga certifikimi i grupit të operatorëve, të cilët i përkasin.

6. Operatori verifikon certifikatat e operatorëve nga të cilët furnizohet.

7. Produktet organike që certifikohen, klasifikohen në kategoritë si më poshtë:

a) bimë dhe produkte me origjinë bimore të papërpunuara, përfshirë farat dhe materiale të tjera mbjellëse dhe shumëzuese bimore;

b) kafshët dhe produktet shtazore të papërpunuara;

c) algat dhe produktet e papërpunuara nga akuakultura;

ç) produktet bujqësore të përpunuara, përfshirë produktet nga akuakultura, të cilat përdoren si ushqim;

d) ushqimet për kafshë;

dh) vera;

e) produkte të tjera të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, ose që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

8. Modeli i certifikatës zyrtare miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 38

Grupi i operatorëve

1. Çdo grup-operatorësh përbëhet vetëm nga anëtarë, të cilët janë fermerë ose operatorë, që prodhojnë alga ose specie të akuakulturës dhe që

mund të kryejnë edhe përpunimin, përgatitjen ose vendosjen në treg të ushqimit ose ushqimit për kafshë.

2. Grupi i operatorëve përbëhet vetëm nga anëtarë:

a) me kosto individuale të certifikimit mbi 2% të xhiros ose vëllimit standard të prodhimit organik të secilit dhe xhiroja vjetore e prodhimit organik nuk është mbi 2 500 000 lekë ose vëllimi standard i prodhimit organik të tyre nuk është mbi 1 500 000 lekë në vit; ose

b) të cilët kanë ferma maksimumi:

i. 5 hektarë;

ii. 0.5 hektarë, në rastin e serave; ose

iii. 15 hektarë, vetëm në rastin e kullotave të përhershme.

c) që zotërojnë personalitet juridik sipas ligjit.

3. Grupi i operatorëve përbëhet vetëm nga anëtarë, të cilët:

a) kryejnë aktivitet prodhues në zona gjeografike pranë njëri-tjetrit;

b) krijojnë një sistem të përbashkët tregtimi për produktet e prodhuara nga grupi;

c) krijojnë një sistem kontrolli të brendshëm, i cili përfshin procedura të dokumentuara të kontrollit të aktiviteteve, në bazë të të cilave një person ose një organ i identifikuar është përgjegjës për të verifikuar plotësimin e kërkesave të këtij ligji nga çdo anëtar i grupit.

4. Trupa e kontrollit i heq gjithë grupit certifikatën zyrtare, kur mangësitë në ngritjen apo funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, veçanërisht pamundësitë për të gjetur dhe për të adresuar mospërputhshmëritë tek anëtarët individualë të grupit të operatorëve, ndikojnë në integritetin e produkteve organike dhe në kalim.

5. Konsiderohen mangësi në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

a) prodhimi, përpunimi, përgatitja ose vendosja në treg e produkteve nga anëtarë ose njësi prodhimi të pezulluara ose të tërhequra;

b) vendosja në treg e produkteve për të cilat menaxheri i sistemit të kontrollit të brendshëm ka ndaluar përdorimin e termave të prodhimit organik në etiketimin ose reklamën e tyre;

c) shtimi i anëtarëve të rinj në listën e anëtarëve ose ndryshimi i aktiviteteve të anëtarëve ekzistues, pa ndjekur procedurën e brendshme të miratimit;



c) moskryerja e inspektimit fizik vjetor në vend të aktivitetit të një anëtarit të grupit në një vit të caktuar;

d) mosraportimi i anëtarëve që janë pezulluar ose janë tërhequr nga lista e anëtarëve;

dh) ndryshime të mëdha në gjetjet midis inspektimeve të brendshme, të kryera nga inspektorët e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kontrolleve zyrtare të kryera nga trupa e kontrollit;

e) mangësi të mëdha në marrjen e masave të duhura ose zbatimit të masave të nevojshme lidhur me mospërputhshmëritë e identifikuara nga inspektorët e sistemit të kontrollit të brendshëm ose nga trupa e kontrollit;

ë) numri i pamjaftueshëm i inspektorëve të sistemit të kontrollit të brendshëm ose kompetencat e pamjaftueshme të inspektorëve për llojin, strukturën, madhësinë, produktet, aktivitetet dhe produktin përfundimtar të prodhimit organik të grupit.

6. Rregulla të tjera lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve miratohen me udhëzim të ministrit.

KREU VI KONTROLLET ZYRTARE

Neni 39 Autoritetet kompetente

Autoritetet kompetente, që ushtrojnë kontrollet zyrtare në zbatim të këtij ligji, janë:

a) autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar lidhur me ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

b) autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermën bujqësore, blegtorale dhe akuakulturës lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe specieve të akuakulturës, si dhe shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Neni 40 Rregullat për kontrollet zyrtare

Rregullat që zbatohen për kontrollet zyrtare në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së produkteve organike, të prodhuara në përputhje me këtë ligj, përfshijnë:

a) rregullat e përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj;

b) rregullat e veçanta të përcaktuara në këtë kre.

Neni 41

Kontrollet zyrtare dhe veprimet që kryhen nga autoritetet kompetente dhe trupat e kontrollit

1. Kontrollet zyrtare për verifikimin e përputhshmërisë me këtë ligj përfshijnë:

a) zbatimin e masave parandaluese dhe paraprake, të përcaktuara në këtë ligj, në çdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes nga operatorët. Verifikimi kryhet nga trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar;

b) verifikimin nga trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar të prodhimit primar në fermë e të dhënave, masave, procedurave ose ndërhyrjeve të kryera për të siguruar ndarjen e dukshme dhe efektive të njësive të prodhimit organik, në kalim dhe joorganik dhe të produkteve përkatëse të prodhuara nga këto njësi, si dhe verifikimin e substancave dhe produkteve të përdorura për njësitë e prodhimit organik, në kalim dhe joorganik, kur ferma përfshin njësi prodhimi joorganike ose në kalim. Një verifikim i tillë përfshin kontrollet në parcelat për të cilat është miratuar një periudhë e mëparshme me efekt prapaveprues, si pjesë e periudhës së kalimit dhe kontrollet në njësitë e prodhimit joorganik;

c) kur produktet organike, në kalim dhe joorganike, vilen apo mblidhen njëkohësisht, përgatiten ose ruhen në të njëjtën njësi përgatitjeje, zonë apo mjedis apo transportohen tek operatorë ose njësi të tjera, verifikimi nga trupa e kontrollit ose autoritetet kompetente përkatës të kontrollit zyrtar:

i. i të dhënave të mbajtura dhe i masave, procedurave ose i zbatimit të masave për të siguruar se veprimet kryhen të ndara në hapësirë ose kohë;

ii. nëse janë zbatuar masat e duhura për pastrimin dhe masat për të parandaluar shkëmbimin e produkteve;

iii. nëse produktet organike dhe në kalim janë të identifikueshme dhe se produktet organike, në kalim dhe joorganike, magazinohen të ndara nga njëra-tjetra, në hapësirë ose kohë, para dhe pas proceseve të përgatitjes.

ç) verifikimin nga trupa e kontrollit i ngritjes dhe funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të grupit të operatorëve;



d) kur operatori është i përjashtuar nga detyrimi i regjistrimit sipas pikës 4 të nenit 34 të këtij ligji, verifikimin nga autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar në treg të ushqimit dhe ushqimit për kafshë nëse kërkesat për këtë përjashtim plotësohen dhe verifikimin nëse produktet e shitura nga këta operatorë plotësojnë kërkesat për përjashtim.

2. Në çdo rast, të gjithë operatorët dhe grupet e operatorëve, me përjashtim të atyre të përcaktuar në pikën 4 të nenit 34 të këtij ligji, i nënshtrohen kontrollit për verifikimin e përputhshmërisë me rregullat e këtij ligji, të paktën një herë në vit.

3. Verifikimi i përputhshmërisë përfshin një inspektim fizik në vend, me përjashtim të rasteve kur:

a) nga kontrollet e mëparshme të operatorit ose grupit të operatorëve nuk janë konstatuar mospërputhje që ndikojnë në integritetin e produkteve organike ose në kalim për të paktën tre vjet radhazi;

b) operatori ose grupi i operatorëve është vlerësuar që paraqet risk të ulët për mospërputhje në bazë të rregullave të përgjithshme për kontrollet zyrtare dhe procedurës së përcaktuar në nenin 42 të këtij ligji. Në këto raste, periudha ndërmjet dy inspektimeve fizike në vend nuk duhet të jetë më shumë se 24 muaj.

4. Kontrollet zyrtare për verifikimin e përputhshmërisë me këtë ligj:

a) kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare, duke siguruar që një përqindje minimale e të gjitha kontrolleve zyrtare të operatorëve ose grupeve të operatorëve kryhen pa paralajmërim;

b) sigurojnë që të kryhen kontrolle shtesë në një përqindje minimale ndaj atyre të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) kryhen me marrjen e një numri minimal të mostrave, përfshirë analizat dhe testet, në përputhje me metodat dhe teknikat e kontrolleve zyrtare, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar;

ç) sigurojnë që një numër minimal i operatorëve, anëtarë të një grupi operatorësh, kontrollohen për verifikimin e përputhshmërisë.

5. Lëshimi ose rinovimi i certifikatës zyrtare bazohet në rezultatet e verifikimit të përputhshmërisë sipas këtij neni.

6. Rregullat e hollësishme për kontrollin e produkteve organike përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 42

Vlerësimi i riskut për kryerjen e kontrollit zyrtar

Kontrollet zyrtare për verifikimin e përputhshmërisë me këtë ligj kryhen gjatë gjithë procesit në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes në bazë të riskut për mospërputhshmëri, i cili përcaktohet bazuar tek elementet e përcaktuara në rregullat e përgjithshme të kontrollit zyrtar dhe tek elementet në vijim:

a) llojin, madhësinë dhe strukturën e operatorit dhe grupit të operatorëve;

b) periudhën e kohës gjatë së cilës operatori dhe grupi i operatorëve janë përfshirë në prodhimin organik, përgatitjen dhe shpërndarjen e tyre;

c) rezultatet e mëparshme të kontrolleve të kryera në përputhje me këtë nen;

ç) kohën më të përshtatshme për aktivitetet e kryera;

d) kategoritë e produkteve;

dh) llojin, sasinë dhe vlerën e produkteve dhe zhvillimin e tyre në kohë;

e) mundësinë e shkëmbimit ose kontaminimit të produkteve organike me produkte apo substanca të palejuara për t'u përdorur në prodhimin organik;

ë) zbatimin e rregullave përjashtuese për operatorët dhe grupet e operatorëve;

f) pikat kritike për mospërputhje dhe mundësinë për mospërputhje në çdo fazë të prodhimit, të përgatitjes dhe të shpërndarjes;

g) aktivitetet e nënkontraktuara.

Neni 43

Dokumentimi i kontrolleve zyrtare

1. Për çdo kontroll zyrtar të kryer për të verifikuar përmbushjen e kërkesave të këtij ligji, trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar harton një procesverbal apo raport me shkrim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar.

2. Procesverbalit ose raportit i kontrollit mbahet me shkrim ose në formë elektronike dhe përmban:

a) një përshkrim të qëllimit të kontrolleve zyrtare;



b) metodat e aplikuara të kontrollit;

c) rezultatet e kontroleve zyrtare;

ç) aty ku është e përshtatshme, masat që trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar kërkon që operatori të ndërmarrë.

3. Procesverbali ose raporti i kontrollit bashkëfirmoset nga operatori ose grupi i operatorëve, si konfirmim për marrjen e këtij raporti.

4. Gjatë mbikëqyrjes së trupave të kontrollit nga autoritetet mbikëqyrëse, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 47 të këtij ligji, nuk lëshohet procesverbal ose raport kontrolli për operatorin ose grupin e operatorëve.

Neni 44

Masat që merren nga operatori dhe grupi i operatorëve

1. Operatori dhe grupi i operatorëve, përveç detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare:

a) mban regjistrime dhe të dhëna që tregojnë përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji;

b) bën të gjitha deklaratat dhe komunikimet e tjera të nevojshme për kontrollet zyrtare;

c) merr masa dhe veprime të duhura për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj.

2. Operatori dhe grupi i operatorëve paraqet një deklaratë, e cila nënshkruhet dhe përditësohet kur është e nevojshme, lidhur me:

a) përshkrimin e plotë të njësisë së prodhimit organik ose në kalim dhe të aktiviteteve që kryhen në përputhje me këtë ligj;

b) masat dhe veprimet përkatëse që merren për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj;

c) marrjen përsipër:

i. të informimit me shkrim dhe pa vonesa të blerësve të produkteve dhe të shkëmbejë informacionet përkatëse me trupën e kontrollit në rast se është vërtetuar një dyshim për mospërputhje, dyshimi për mospërputhje nuk eliminohet ose kur vërtetohet mospërputhja që prek integritetin organik të produkteve në fjalë;

ii. të pranimit të transferimit të dosjes së kontrollit në rastin e ndryshimit të trupës së kontrollit ose në rastin e largimit ose tërheqjes nga prodhimi organik të ruajë për të paktën pesë vjet dosjen e kontrollit të kryer nga trupa e kontrollit;

iii. të informimit në mënyrë të menjëhershme të autoritetit kompetent, sipas fushës përkatëse për kontrollin zyrtar në rast të largimit ose tërheqjes nga sistemi i kontrollit të prodhimit organik;

iv. për të pranuar shkëmbimin e informacioneve me trupat e tjerë të kontrollit në rastin kur nënkontraktorët kontrollohen nga trupa të ndryshëm kontrolli.

3. Rregullat e hollësishme lidhur me të dhënat që duhet të mbahen nga operatorët dhe grupi i operatorëve, deklaratat dhe komunikimet e tjera, të nevojshme për kontrollet zyrtare, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 45

Trupa e kontrollit

1. Trupa e kontrollit, me qëllim verifikimin e plotësisë të rregullave të përcaktuara në këtë ligj, kryen detyrat e mëposhtme:

a) kontrollin zyrtar të specializuar, me qëllim certifikimin e operatorit dhe grup-operatorëve në sistemin e tyre të kontrollit për certifikimin organik dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me to;

b) miratimin e përjashtimit për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kalim dhe joorganik, në prodhimin organik.

2. Aplikimi për miratimin dhe rinovimin e miratimit të trupave të kontrollit, që certifikojnë sipas këtij ligji, dhe aplikimi për njofim nga trupat që veprojnë sipas standardeve të tjera kryhet *online* nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”.

3. Trupa e kontrollit miratohet për kryerjen e detyrave të caktuara në këtë ligj vetëm nëse plotëson kushtet për ushtrimin e detyrave të kontrollit zyrtar, të përcaktuara në legjislacionin për kontrollin zyrtar, dhe në veçanti, kur:

a) është e regjistruar në regjistrin tregtar në përputhje me ligjin për regjistrimin e aktivitetit tregtar;

b) ka procedurën e vlerësimit të riskut, e cila përcakton bazën për intensitetin dhe shpeshhtësinë e verifikimit të përputhshmërisë së operatorit dhe grupit të operatorëve, e cila përcaktohet në nenin 42 të këtij ligji;

c) ka një procedurë standarde të kontrollit, e cila përmban një përshkrim të detajuar të masave të kontrollit, që trupa e kontrollit ndërmerr ndaj operatorëve nën kontrollin e saj;



c) ka një listë masash që janë në përputhje me katalogun e përbashkët të masave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 51 të këtij ligji, që merren për operatorin dhe grupin e operatorëve, në rastet e mospërputhjeve të dyshuara ose të vërtetuara;

d) ka një përshkrim të qartë për monitorimin efektiv të detyrave të caktuara për kontrollin zyrtar dhe aktivitete të tjera zyrtare, që trupa e kontrollit kryen në lidhje me operatorin dhe grupin e operatorëve, si dhe raportimin për kryerjen e tyre.

dh) është e akredituar si trupë certifikuese e produkteve organike për fushën e këtij ligji, në përputhje me standardet e harmonizuara për akreditimin.

4. Shqyrtimi i kërkesës së trupave të kontrollit sipas pikës 2 të këtij neni, kryhet në sistemin elektronik për shërbimet e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

5. Trupa e kontrollit njofton ministrinë për ndryshimet e elementeve të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh” të pikës 3 të këtij neni.

6. Miratimi ose refuzimi i kërkesës për miratim të trupës së kontrollit bëhet me urdhër të ministrit.

7. Trupa e kontrollit, që vepron në Shqipëri sipas standardeve të tjera ndërkombëtare për prodhimin organik, njofton aktivitetin e saj në ministri.

8. Në përjashtim nga legjislacioni në fuqi për kontrollin zyrtar, ministria i cakton një trupe kontrolli detyrat në lidhje me masat që merren në rast të konstatimit të mospërputhjeve, sipas katalogut të përbashkët të masave, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 51 të këtij ligji.

9. Trupa e kontrollit nuk kryen detyrat lidhur me:

a) mbikëqyrjen dhe auditimin e trupave të tjerë të kontrollit;

b) kompetencat për të miratuar përjashtimet nga rregullat e prodhimit, përveç përjashtimit për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik;

c) pranimin e kërkesave për regjistrim të aktivitetit të operatorëve ose grup-operatorëve;

c) vlerësimin e mundësisë së ndodhjes së mospërputhjeve me kërkesat e këtij ligji që përcaktojnë shpeshhtësinë e kontroleve fizike në pikat e inspektimit kufitar të ngarkesave të produkteve organike para lëshimit për vendosje në treg;

d) hartimin e katalogut të përbashkët të masave, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 51 të këtij ligji.

10. Kushtet e tjera dhe procedurat për miratimin e trupave të kontrollit dhe njoftimin e aktivitetit nga trupat e kontrollit, që veprojnë në Shqipëri sipas standardeve të tjera për prodhimin organik, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Tarifat për miratimin e trupave të kontrollit dhe njoftimin e aktivitetit nga trupat e kontrollit, që veprojnë në Shqipëri sipas standardeve të tjera për prodhimin organik, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 46

Komisioni për Prodhimin Organik

1. Në ministri ngrihet dhe funksionon Komisioni për Prodhimin Organik (KPO), i cili propozon miratimin, rinovimin, shfuqizimin e miratimit të trupave të kontrollit, që certifikojnë operatorët organikë dhe produktet organike sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe kryen detyra të tjera sipas këtij ligji.

2. Kundër vendimit të KPO-së dhe/ose urdhrat të ministrit, trupa e kontrollit ka të drejtën e ankimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. KPO-ja është përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave ndaj masave administrative të vendosura ndaj operatorit, grup-operatorëve dhe trupës së kontrollit nga autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar.

4. Përbërja, funksionimi dhe organizimi i Komisionit për Prodhimin Organik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje për anëtarët e KPO-së përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për caktimin e vlerës së shpërblimeve.

Neni 47

Mbikëqyrja e trupave të kontrollit

1. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, në bashkëpunim me autoritetin kompetent të kontrollit zyrtar të prodhimit primar, në fermë bujqësore ose në akuakulturë, kryen mbikëqyrjen e trupave të kontrollit dhe i raporton KPO-së.

2. Komisioni vlerëson raportin e paraqitur sipas pikës 1 të këtij neni dhe vendos lidhur me aktivitetin e trupës së kontrollit.



3. Autoritetet mbikëqyrëse, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbatojnë procedura dhe masa për të siguruar mbikëqyrjen e trupave të kontrollit, të miratuar për të verifikuar nëse detyrat e caktuara kryhen në mënyrë efektive, të pavarur dhe objektive, kryesisht për intensitetin dhe shpeshhtësinë e kontrolleve zyrtare për verifikimin e përrputhshmërisë me kërkesat e këtij ligji.

4. Mbikëqyrja e trupave të kontrollit, në zbatim të kërkesave të legjislacionit për kontrollin zyrtar dhe të këtij ligji, kryhet të paktën një herë në vit, duke shmangur mbivendosjen me mbikëqyrjen nga organizmi akreditues.

5. Informacionet e marra nga trupat e kontrollit dhe masat e zbatuara prej tyre, në rast mospërputhjeje të konstatuar ose të dyshuar, përdoren për të mbikëqyruar aktivitetet e këtyre trupave të kontrollit.

Neni 48

Pezullimi i trupave të kontrollit

1. Ministri mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht miratimin e trupës së kontrollit:

a) për një periudhë jo më shumë se 12 muaj, gjatë së cilës trupa e kontrollit duhet të korrigjojë mangësitë e gjetura gjatë auditimeve dhe inspektimeve ose të adresojë mospërputhjet për të cilat janë informuar trupat e tjerë të kontrollit, autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar dhe ministria, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji; ose

b) për periudhën gjatë së cilës akreditimi në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar është pezulluar.

2. Kur pezullohet miratimi, trupa e kontrollit nuk lëshon certifikata zyrtare për pjesën e fushës së pezulluar. Ministri, në bazë të propozimit të KPO-së, vendos për vlefshmërinë e certifikatave të lëshuara nga trupa e kontrollit përpara datës së këtij pezullimi dhe informon operatorët për vendimin.

3. Pa prekur detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar, ministri heq pezullimin e miratimit të trupës së kontrollit kur trupa e kontrollit korrigjon mangësitë ose mospërputhjet e dyshuara ose menjëherë pas heqjes së pezullimit të akreditimit nga organi i akreditimit.

4. Kur një trupë kontrolli, e miratuar nga ministri, është njohur edhe nga Komisioni Evropian për të certifikuar operatorët organikë në Shqipëri, sipas standardeve të tjera ndërkombëtare dhe i është

hequr njohja, autoriteti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të nenit 47 të këtij ligji, organizon auditime ose inspektime të aktivitetit të kësaj trupe kontrolli në përputhje me legjislacionin për kontrollin zyrtar.

Neni 49

Shfuqizimi i miratimit të trupave të kontrollit

1. Ministri, me propozimin e KPO-së, shfuqizon plotësisht ose pjesërisht miratimin e trupave të kontrollit në rastin kur është hequr plotësisht statusi i akreditimit ose i është reduktuar akreditimi për aktivitetin e mbuluar nga ky ligj, si dhe në rastet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar.

2. Kur ministri ka shfuqizuar tërësisht ose pjesërisht miratimin e trupave të kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar, ministri vendos edhe për vlefshmërinë e certifikatave të lëshuara nga trupat e kontrollit përpara datës së këtij shfuqizimi dhe i njofton operatorët për këtë vendim.

Neni 50

Informacionet që paraqiten nga trupa e kontrollit

1. Trupa e kontrollit e miratuar, përveç detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar, paraqet në ministri dhe tek autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar:

a) listën e operatorëve në sistemin e saj të kontrollit brenda datës 31 janar të çdo viti për vitin paraardhës;

b) të gjithë informacionin statistikor në lidhje me operatorët organikë nën kontrollin e saj deri më 1 mars të çdo viti dhe sa herë kërkohet;

c) deri më 1 mars të çdo viti raportin vjetor për kontrollet zyrtare të kryera gjatë vitit paraardhës.

2. Modeli dhe përmbajtja e raportit vjetor për prodhimin organik miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 51

Masat në rast të mospërputhjeve të dyshuara

1. Kur trupa e kontrollit ose një autoritet kompetent përkatës i kontrollit zyrtar dyshon ose



merr informacion, përfshirë informacionin nga autoritete kompetente ose trupa kontrolli të tjera, se një operator përdor ose vendos në treg një produkt, i cili nuk është në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, por përmban terma që i referohen prodhimit organik ose informohen nga një operator për një dyshim për mospërputhje:

a) kryen menjëherë një hetim zyrtar për të verifikuar përputhshmërinë me këtë ligj. Ky hetim përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, duke marrë parasysh jetëgjatësinë e produktit dhe kompleksitetin e rastit;

b) ndalon përkohësisht vendosjen në treg të produkteve me referencë organike ose në kalim dhe përdorimin e tyre në prodhimin organik, në pritje të rezultateve të hetimit zyrtar, siç përcaktohet në shkronjën “a” të kësaj pike. Para marrjes së një vendimi të tillë, trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar i jep operatorit mundësinë për të paraqitur mendimin e tij.

2. Në rast se rezultatet e hetimit zyrtar nuk tregojnë ndonjë mospërputhje, që ndikon në integritetin e produkteve organike ose në kalim, operatori lejohet t'i përdorë këto produkte ose t'i vendosë në treg si produkte organike ose në kalim.

3. Rregullat e hollësishme për hartimin e katalogut të përbashkët të masave dhe formati i tij miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 52

Masat në rast të mospërputhjeve që prekin integritetin organik

1. Në rast të mospërputhjeve që prekin integritetin e produkteve organike ose në kalim në çdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, si rasti i përdorimit të produkteve, substancave ose teknikave të palejuara në prodhimin organik ose shkëmbimit të produkteve organike me ato joorganike, trupa e kontrollit, përveç masave të marra në rast të mospërputhjeve të konstatuara, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar, siguron që në etiketimin dhe reklamimin e gjithë lotit të prodhimit në fjalë ose prodhimit në proces, nuk vendoset asnjë referencë për prodhimin organik.

2. Në rast të një mospërputhjeje serioze që prek integritetin organik, të përsëritur në vazhdimësi, trupa e kontrollit dhe autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar sigurojnë që përveç masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, operatori ose

grupi i operatorëve ndalohen të tregtojnë produkte me terma të prodhimit organik për një periudhë të caktuar dhe certifikata zyrtare e tyre pezullohet ose revokohet sipas rastit.

Neni 53

Rregulla për shkëmbimin e informacionit

1. Përveç detyrimit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare, autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupat e kontrollit shkëmbejnë menjëherë informacionin midis tyre, me ministrinë dhe me autoritetet kompetente të vendeve të tjera për një dyshim për mospërputhje, që prek integritetin e produkteve organike ose në kalim.

2. Në rastet kur dyshohet ose konstatohet mospërputhje në produktet që kontrollohen nga një trup tjetër kontrolli, atëherë trupa e kontrollit njofton menjëherë trupën tjetër. Trupat e kontrollit shkëmbejnë midis tyre edhe informacione të tjera përkatëse.

3. Me marrjen e një kërkesë për informacion, e cila justifikohet nga nevoja për të siguruar se një produkt është prodhuar në përputhje me këtë ligj, trupat e kontrollit shkëmbejnë informacion për rezultatet e kontrolleve të kryera me autoritetin kompetent përkatës të kontrollit zyrtar dhe ministrinë.

4. Autoritetet e mbikëqyrjes së trupave të kontrollit, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 47 të këtij ligji, dhe organizmi i akreditimit shkëmbejnë midis tyre informacionet për auditimet e kryera, statuset e miratimit dhe akreditimit të trupave të kontrollit dhe çdo informacion tjetër që mund të ndikojë në miratimin ose akreditimin.

5. Autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupat e kontrollit sigurojnë që informacionet për rezultatet e kontrolleve t'i komunikohen agjencisë së pagesave në përputhje me nevojat e saj.

6. Autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar, të përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji, paraqesin në ministri:

a) deri më 31 janar të çdo viti listën e operatorëve organikë të regjistruar gjatë vitit paraardhës;

b) deri më 1 mars të çdo viti raportin vjetor për kontrollet zyrtare të kryera sipas fushës së përgjegjësisë, mospërputhjet e konstatuara, masat e sanksionet e marra dhe përjashtimet nga rregullat e



prodhimit të miratuara gjatë vitit paraardhës dhe çdo informacion tjetër kur kërkohet nga ministria.

KREU VII RREGULLAT E TREGTIMIT ME VENDET E TJERA

Neni 54

Eksporti i produkteve organike

1. Një produkt eksportohet nga Shqipëria si produkt organik nëse plotëson kushtet e vendit ku eksportohet.

2. Një produkt eksportohet dhe mund të mbajë logon kombëtare për prodhimin organik nëse plotëson rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Eksportuesi duhet të regjistrojë aktivitetin në përputhje me pikën 1 të nenit 34 të këtij ligji.

Neni 55

Kushtet e importit të produkteve organike dhe në kalim

1. Një produkt importohet nga një vend anëtar i BE-së ose një vend i tretë për t'u vendosur në tregun shqiptar si produkt organik ose në kalim me kusht që:

a) produkti përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji;

b) përmbush një nga kushtet e mëposhtme:

i. produkti vjen nga një vend anëtar i BE-së dhe shoqërohet me certifikatën e operatorit organik, e cila konfirmon se produkti është në përputhje me rregullat e BE-së për prodhimin organik;

ii. produkti vjen nga një vend i tretë dhe është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në krerët II, III, IV dhe V të këtij ligji dhe të gjithë operatorët dhe grupet e operatorëve, përfshirë eksportuesit në vendin e tretë, u janë nënshtruar kontrolleve nga trupat e kontrollit ose autoritetet e kontrollit të njohura nga Komisioni Evropian, si të përputhura për importin e produkteve organike në BE dhe këto trupa kontrolli kanë pajisur të gjithë këta operatorë, grupe të operatorëve dhe eksportues me një certifikatë, ku vërtetohet se ata janë në përputhje me rregullat e BE-së për prodhimin organik dhe ngarkesa shoqërohet me certifikatën e operatorit organik;

iii. në rastet kur produkti vjen nga një vend i tretë, i cili është njohur si ekuivalent ose në përputhje

me marrëveshje tregtare me BE-në për importin e produkteve organike në Bashkimin Evropian dhe produkti përputhet me rregullat e prodhimit dhe kontrollit të atij vendi të tretë, të cilat janë në përputhje me këtë ligj dhe shoqërohet me certifikatën e operatorit organik, të lëshuar nga autoritetet kompetente, autoritetet e kontrollit ose trupat e kontrollit të vendit të tretë;

iv. në rastet kur produkti vjen nga një vend i tretë, i cili është i njohur si në përputhje nga Shqipëria, nëpërmjet një marrëveshjeje tregtare, që ka një sistem prodhimi organik, i cili plotëson të njëjtët objektiva e parime dhe zbaton rregulla që sigurojnë të njëjtin nivel përputhshmërie me këtë ligj.

2. Operatorët e vendeve anëtare të BE-së ose të një vendi të tretë u japin në çdo kohë importuesve, autoriteteve kompetente në Shqipëri dhe të vendeve të treta informacionet për identifikimin e furnizuesve të tyre dhe të autoriteteve të kontrollit ose trupave të kontrollit të furnizuesve të tyre, në mënyrë që të sigurohet gjurmueshmëria e produktit organik ose në kalim. Këto informacione u vihen në dispozicion edhe trupave të kontrollit të importuesve.

Neni 56

Kontrolli i produkteve të importuara

1. Kontrolli i përputhshmërisë me kushtet dhe masat për importin e produkteve organike dhe në kalim kryhet nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar në pikat e inspektimit kufitar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar në pikat e inspektimit kufitar.

2. Frekuenca e kontrolleve fizike të produkteve, të importuara sipas legjislacionit në fuqi për kontrollet zyrtare, varet nga niveli i riskut për mospërputhje me rregullat e këtij ligji.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave paraqet në ministri një raport vjetor për produktet organike të eksportuara dhe të importuara deri më 1 mars të çdo viti për vitin paraardhës. Raporti përmban vendin ku eksportohet ose importohet, emrin e eksportuesit ose importuesit, kategorinë, sasinë dhe vlerën e produkteve organike të eksportuara dhe të importuara.

4. Rregullat e hollësishme lidhur me kushtet, masat dhe kontrollet e ngarkesave të produkteve



organike ose në kalim të importuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 57

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet ndaj operatorëve organikë

1. Trupa e kontrollit ushtron kontroll në përputhje me katalogun e masave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 51 të këtij ligji.

2. Në rast të përsëritjes së shkeljeve, pas vendosjes së masave nga trupa e kontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe për atë që nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe jepen dënimet administrative nga autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar në përputhje me ligjin e posaçëm për inspektimin si më poshtë:

a) paralajmërim me shkrim;

b) urdhërimi i operatorit organik për të korrigjuar shkeljet e konstatuara e për të eliminuar pasojat e tyre;

c) dënimi me gjobë.

3. Në rastin e dënimit me gjobë nga autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar, sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij neni, vendosen dënimet administrative të mëposhtme:

a) përdorimi i rrezatimit jonizues në kundërshtim me pikën 6 të nenit 9 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 150 000 deri në 200 000 lekë;

b) përdorimi i klonimit të kafshëve dhe rritja e kafshëve poliploide të induktuara artificialisht në kundërshtim me pikën 7 të nenit 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 150 000 deri në 200 000 lekë;

c) mosrespektimi i një prej kërkesave sipas pikës 13 të nenit 9 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë. Mosrespektimi i më shumë se një prej kërkesave sipas pikës 13 të nenit 9 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

ç) tregtimi i produkteve të prodhuara gjatë periudhës së kalimit, si produkte organike ose në kalim, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 10 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

d) tregtimi i produkteve në kalim pa u plotësuar kushtet e shkronjës “a” të pikës 4 të nenit 10 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 10 000 lekë;

dh) tregtimi i produkteve në kalim pa u plotësuar kushtet e shkronjës “b” të pikës 4 të nenit 10 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë;

e) përdorimi i OMGJ-ve dhe produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ në kundërshtim me pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 150 000 deri në 200 000 lekë;

ë) ushtrimi i aktivitetit të prodhimit blegtoral organik pa tokë, kur fermeri nuk administron ose disponon tokë bujqësore, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 deri në 100 000 lekë;

f) shkelja e rregullave të veçanta të prodhimit, të parashikuara në nenet 13 deri në 18 të këtij ligji, përveç rasteve përjashtimore, sipas këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 30 000 deri në 50 000 lekë;

g) mosmarrja e masave për të parandaluar çdo përzierje ose shkëmbim të mundshëm midis produkteve organike, në kalim dhe joorganike, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 20 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 deri në 100 000 lekë;

gj) përdorimi në prodhimin organik i produkteve të palejuara në kundërshtim me pikën 4 të nenit 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

h) përdorimi në prodhimin organik i PMB-së dhe produkteve plehëruese të pamiratuara në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

i) përdorimi në prodhimin organik i produkteve të palejuara në kundërshtim me pikën 3 të nenit 22 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

j) përdorimi në prodhimin organik i produkteve të palejuara në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

k) mosrespektimi i një prej kërkesave, sipas pikës 1 të nenit 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë. Mosrespektimi i më shumë se një prej kërkesave, sipas pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

l) vendosja në treg si produkt organik ose në kalim dhe përdorimi në prodhimin organik i produkteve për të cilat është konstatuar që në prodhimin e tyre janë përdorur produkte dhe



substancia të palejuara në prodhimin organik, në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

ll) vendosja në treg si produkt organik ose në kalim dhe përdorimi në prodhimin organik i produkteve nga operatori që nuk ka marrë masat paraprake, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 26 të këtij ligji dhe nuk ka marrë masa në zbatim të gjetjeve të lëna nga autoriteti kompetent ose trupa e kontrollit, në kundërshtim me shkronjat “b” dhe “c” të pikës 2 të nenit 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

m) mosmarrja e masave korrigjuese të nevojshme për të shmangur ndotjet në të ardhmen, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

n) përdorimi i termave “organik”, “biologjik”, “bio”, “eko” për etiketimin, reklamimin ose në dokumentet tregtare të një produkti të përcaktuar në fushën e këtij ligji, por që nuk plotëson kërkesat e këtij ligji, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 28 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

nj) përdorimi i termave “organik”, “biologjik”, “bio”, “eko”, si markë tregtare, emra të kompanisë ose njësive të shitjes apo praktika të tjera të përdorura në etiketim ose reklamim, që keqinformojnë ose mashtrojnë konsumatorin, duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 28 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 deri në 100 000 lekë;

o) etiketimi ose reklamimi si produkte organike ose në kalim i produkteve të prodhuara gjatë periudhës së kalimit, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 28 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

p) mungesa e vendosjes së përbërësve organikë në listën e përbërësve, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 10 000 lekë;

q) mungesa e vendosjes në etiketim i emrit dhe numrit të kodit të trupës së kontrollit, subjekt i së cilës ka qenë operatori që ka kryer veprimin, procesin e fundit të prodhimit ose përgatitjes, në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë;

r) mungesa e vendosjes së logos kombëtare në kundërshtim me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 32

dhe me pikën 1 të nenit 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë;

rr) përdorimi i logos kombëtare për prodhimin biologjik në kundërshtim me pikën 3 të nenit 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

s) mungesa e vendosjes në etiketim të treguesit të vendit ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore nga të cilat përbëhet produkti, kur përdoret logoja shqiptare e prodhimit organik për produktet e importuara, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë;

sh) vendosja në treg e produkteve të fushës së zbatimit të këtij ligji, si produkte organike ose produkte në kalim nga operatorët dhe grupet e operatorëve, pa regjistruar aktivitetin ose pa certifikatë zyrtare, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 deri në 100 000 lekë;

t) mosngritja e sistemit të kontrollit të brendshëm nga grupi i operatorëve dhe moskaktimi i personit ose organit përgjegjës për të verifikuar plotësimin e kërkesave të këtij ligji nga çdo anëtar i grupit, në kundërshtim me shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 38 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

th) mosrespektimi i një prej kërkesave sipas pikës 1 të nenit 44 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë. Mosrespektimi i më shumë se një prej kërkesave sipas pikës 1 të nenit 44 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

4. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 58

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet ndaj trupave të kontrollit

1. Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj, nga ana e trupave të kontrollit, të miratuara dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe jepen dënimet administrative nga autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar në përputhje me ligjin e posaçëm për inspektimin si më poshtë:

a) paralajmërim me shkrim;

b) urdhërimi i trupës së kontrollit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara e për të eliminuar pasojat e tyre;



c) dënimi me gjobë.

2. Në rastin e dënimit me gjobë nga autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, vendosen dënimet administrative të mëposhtme:

a) lëshimi i certifikatës zyrtare për operatorin ose grupin e operatorëve në kundërshtim me pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 100 000 deri në 200 000 lekë;

b) kur gjatë mbikëqyrjes konstatohet mungesa e përmbushjes dhe zbatimit të kushteve të miratimit, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 45 të këtij ligji, trupa e kontrollit dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

c) kur gjatë mbikëqyrjes konstatohet mungesa e përmbushjes dhe zbatimit të kushteve të miratimit, në kundërshtim me më shumë se një nga kushtet e pikës 3 të nenit 45 të këtij ligji, trupa e kontrollit dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

ç) mungesa e njoftimit për ndryshimet e elementeve për të cilat është miratuar një trupë kontrolli, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë;

d) lëshimi i certifikatave zyrtare për pjesën e fushës së pezulluar, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 200 000 lekë;

dh) lejimi i vendosjes në treg të produkteve me referencë organike ose në kalim dhe përdorimi i tyre në prodhimin organik përpara daljes së rezultateve të hetimit zyrtar, në kundërshtim me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 51 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

e) mosparaqitja rregullisht e informacioneve nga trupat e kontrollit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë;

ë) mosmarrja e masave nga trupa e kontrollit, në rast të mospërputhjeve që prekin integritetin organik, në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

f) shkelja e rregullave për shkëmbimin e informacionit nga trupa e kontrollit, në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 30 000 lekë.

3. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 59

Përgjegjësia administrative

1. Çdo operator dhe grup-operatorësh mbajnë përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në pikën 3 të nenit 57 të këtij ligji.

2. Trupa e kontrollit e miratuar mban përgjegjësi administrative për shkeljet administrative, të parashikuara në pikën 2 të nenit 58 të këtij ligji.

Neni 60

Ankimi i sanksioneve administrative

Trupa e kontrollit ose operatori ose grupi i operatorëve, ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, mund të bëjë ankim në ministri sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 61

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore të parashikuara në nenet, 27, pika 6; 33, pika 7; 45, pika 10; 46, pika 4; dhe 56, pika 4, të këtij ligji brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri për miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në nenet 2, pika 1, shkronja “ç”; 10, pika 5; 11, pika 5; 12, pika 7; 13, pika 10; 14, pika 3; 15, pika 5; 16, pika 6; 17, pika 3; 18, pika 4; 19, pika 5; 20, pika 4; 21, pika 4; 22, pika 3; 24, pika 6; 36, pika 6; 37, pika 8; 38, pika 6; 41, pika 6; 44, pika 3; 45, pika 11; 50, pika 2, dhe 51, pika 3, të këtij ligji brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 62

Dispozita kalimtare

1. KPB-ja, e ngritur dhe e organizuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, vazhdon



veprimtarinë deri në ngritjen dhe organizimin e KPO-së sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Trupat e kontrollit ndjekin procedurat e miratimit pranë KPB-së sipas parashikimeve të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” deri në miratimin e aktit nënligjor, të përcaktuar në pikën 10 të nenit 45 të këtij ligji.

Neni 63
Shfuqizime

1. Ligji nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” shfuqizohet me fillimin e efekteve të këtij ligji.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, për aq sa nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, zbatohen deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, sipas këtij ligji.

Neni 64
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet 2 vjet pas hyrjes në fuqi.

Miraturar në datën 19.9.2024.

Shpallur me dekretin nr. 355, datë 10.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 355, datë 10.10.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 105/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
43/2020, “PËR AKTIVITETET E
TURIZMIT DETAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pika 14 ndryshohet si më poshtë:
“14. “Operator i turizmit detar” është ai subjekt, që ushtron aktivitete të turizmit detar, i cili është i certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:
a) Në pikën 1 fjala “të licencuar” zëvendësohet me fjalën “të certifikuar”;
b) Pika 2 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 12, në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Fjalët “operator turistik detar” zëvendësohen me fjalët “operator i turizmit detar”.
b) Fjala “i licencuar” zëvendësohet me fjalën “i certifikuar”.

Neni 4

Në nenin 24 bëhen ndryshimet si më poshtë:
a) Në pikën 1 në shkronjën “ç” fjala “licencën” hiqet.
b) Në pikën 3 fjalët “lejes/licencës” hiqen.



Neni 5

Në nenin 25 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Pika 2 shfuqizohet.
- Në pikën 3 fjalët “sipas pikave 1 dhe 2” zëvendësohen me fjalët “sipas pikës 1”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.9.2024.

Shpallur me dekretin nr. 356, datë 10.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 356, datë 10.10.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 105/2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 43/2020, ‘Për aktivitetet e turizmit detar’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM**Nr. 625, datë 10.10.2024****PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR
MBAJTJEN E ARMËS NË PËRDORIM
PERSONAL, EDHE JASHTË ORËVE TË
SHËRBIMIT, NGA PUNONJËSI I
POLICISË SË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 14, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, i cili, për shkak të detyrës, pajiset me armë në përdorim personal, ka të drejtë që këtë armë ta mbajë me vete, edhe jashtë orëve të shërbimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve për të mbajtur armën në përdorim personal, edhe jashtë orëve të shërbimit, duhet të plotësojë këto kushte:

- ndaj tij të mos ketë nisur ndjekja penale;
- në banesën e tij të jetë instaluar kasete e posaçme për ruajtjen e armës.

3. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Armë në përdorim personal”, pistoleta ose arma e shkurtër e vënë në dispozicion nga institucioni, në të cilin është emëruar punonjësi i Policisë së Burgjeve;

b) “Institucion i Vuajtjes së Veprës Penale” (IEVP), institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim;

c) “Kasetë”, një mbajtëse e bërë posaçërisht për të mbajtur armë zjarri, e blinduar, me trashësi e mekanizëm dhe çelës sigurie, e cila duhet të betonohet ose të saldohet në mënyrë të palëvizshme në mur, për të hequr mundësinë e rrëmbimit së bashku me armën;

ç) “Punonjës i Policisë së Burgjeve”, punonjësi, i cili ushtron detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse ose ekzekutuese për garantimin e rendit e të sigurisë në IEVP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;

d) “Titullar”, drejtuesi i IEVP-së ose drejtori i Policisë së Burgjeve për rastet kur kërkuesi është i emëruar në strukturën qendrore të Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

4. Për t’u pajisur me autorizim për të mbajtur armën në përdorim personal, edhe jashtë orëve të shërbimit, punonjësi bën një kërkesë drejtuar titullarit.

5. Titullari për shqyrtimin e kërkesave ngre një komision, i cili kryesohet prej tij dhe ka në përbërje:

- eporin e drejtpërdrejtë të kërkuesit;
- drejtorin e burimeve njerëzore të strukturës në të cilin është emëruar kërkuesi;

c) shefin e Policisë së strukturës në të cilën është emëruar kërkuesi;

ç) përgjegjësën e armatimit të strukturës në të cilën është emëruar kërkuesi.



6. Kërkesa përgatitet me shkrim dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vetëdeklarimin për pajisjen me kasetë metalike për mbajtjen e armës në banesë;

b) dëshminë nga gjykata dhe prokuroria në juridiksionin territorial të të cilit punonjësi ka vendbanimin që nuk është në ndjekje penale;

c) dëshminë e aftësisë për punë, e lëshuar nga organet kompetente.

7. Komisioni merr në shqyrtim dhe shprehet me vendim të arsyetuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së punonjësit të Policisë së Burgjeve.

8. Në rast se vlerësohet e nevojshme, Komisioni mund të njoftojë kërkuesin që të paraqitet për t'u pyetur ose për t'i kërkuar dokumentacion shtesë, duke i caktuar edhe një afat për këtë.

9. Në rastin e parashikuar në pikën 7, të këtij vendimi, afati i shqyrtimit pezullohet derisa kërkuesi të përmbushë kërkesat e Komisionit ose deri në përfundimin e afatit të caktuar. Në rast se ky i fundit nuk paraqitet ose nuk përcjell dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar, Komisioni vendos mospranimin e kërkesës.

10. Për rastet kur kërkuesi plotëson kushtet, Komisioni nxjerr autorizimin për mbajtjen e armës në përdorim personal, edhe jashtë orëve të shërbimit.

11. Në rastet kur Komisioni vlerëson që kërkuesi nuk i plotëson kushtet për mbajtjen e armës në përdorim personal, edhe jashtë orëve të shërbimit, vendos refuzimin e kërkesës, me vendim të arsyetuar dhe ia komunikon kërkuesit.

12. Kundër vendimit të refuzimit kërkuesi ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente.

13. Jashtë orëve të shërbimit, arma mbahet nën veshje e paeksponuar, në brez ose nën sqetull, e futur në këllëf të siguruar me kapëse që të mos dalë në mënyrë të pavullnetshme, në gjendje të shkrehur dhe e vendosur në siguresë, pa fishekë në follenë e fishekut dhe pa krehër.

14. Në banesë, arma ruhet brenda ambientit të saj, në kasetë metalike të posaçme, të siguruar me çelës, që mbahet nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, për të mos u përdorur nga persona të tjerë, si dhe të mos ketë elemente të dukshme ekspozimi apo perceptimi.

15. Arma në kasetë ruhet e vendosur në siguresë dhe e ndarë nga municioni dhe duhet të sigurohet me kavo bllokimi, i cili kalon në fyellin e tytës ose

me bllokues të këmbëzës së shkrepjes, të kyçur me çelës, i cili mbahet nga përdoruesi i certifikuar i armës së zjarrit.

16. Verifikimi i kushteve të ruajtjes së armëve në banesë realizohet nga një specialist policie, i autorizuar nga titullari, gjatë shqyrtimit të kërkesës sipas pikës 6, të këtij vendimi.

17. Në rastet kur punonjësi pezullohet, lirohet ose largohet nga Policia e Burgjeve automatikisht humb të drejtën e mbajtjes së armës personale jashtë orëve të shërbimit, si dhe detyrohet ta dorëzojë menjëherë këtë të fundit.

18. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 627, datë 10.10.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 440, DATË 19.7.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË
KREDITIMIT STUDENTOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 440, datë 19.7.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Studenti, i cili nuk është subjekt i përfitimeve prej akteve të tjera, që mbështetin studentin me bursa, mbështetje financiare apo përjashtime nga tarifat, ka të drejtë të aplikojë për kredi studentore pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda muajit shkurt. Aplikimi shoqërohet me dokumentacionin, që vërteton



regjistrimin si student në institucionin përkatës të arsimit të lartë dhe numrin e matrikullimit.”.

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga shpallja e listës me renditjen e kërkesave për të përfituar kredi studentore, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë ua paraqet këtë listë bankave të nivelit të dytë, të cilat kanë pranuar të ofrojnë kredinë studentore, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, me normën më të ulët të interesit. Brenda të njëjtit afat, njoftohen elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” edhe studentët për vijimin e procedurave dhe lidhjen e kontratës së kredisë me bankën përkatëse.”.

c) Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Procedura e aplikimit, sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet pasi të jetë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare njoftimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin për përfundimin e implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet për kredi studentore bëhen me kërkesë pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga AKFAL-i, deri në çastin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave të këtij vendimi, në fuqi në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 628, datë 10.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “a”, e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) vlerësimin e jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.”.

b) Pas pikës 34 shtohet pikat 34/1, me këtë përmbajtje:

“34/1. Procedurat e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik “e-Albania”, zbatohen pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ASCAL-it.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ASCAL-i, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL, trajtohen dhe zhvillohen sipas



dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

c) Në tabelën 2/c, bashkëlidhur vendimit, tarifa e përcaktuar në nënndarjen me nr. 3 shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 629, datë 10.10.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 418, DATË 10.5.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
STANDARDET, KRITERET DHE
PROCEDURAT PËR HAPJEN,
RIORGANIZIMIN, NDARJEN,
BASHKIMIN OSE MBYLLJEN E
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË DHE TË DEGËVE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, 30 e 31, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Subjekte juridike, vendëse ose të huaja, të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo në gjykatën kompetente, aplikojnë në portalin unik qeveritar “e-Albania” për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues. Afati fundor i depozitimit është data 15 (pesëmbëdhjetë) tetor, për vitin pasardhës akademik.”.

2. Shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Aplikimi dhe dokumentacioni për hapjen e institucionit të arsimit të lartë ngarkohet në portalin unik qeveritar “e-Albania”;

...

c) Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” plotësimi i tij, brenda 3 (tri) javëve nga marrja e raportit të vlerësimit;

ç) Në rastin e refuzimit të aplikimit, ministria përgjegjëse për arsimin informon aplikantin elektronikisht, me dokument me vulë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” për vendimin dhe shkaqet e marrjes së tij, brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit.”.

3. Shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Aplikimi dhe dokumentacioni për riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë ngarkohet në portalin unik qeveritar “e-Albania”. Iniciativa për riorganizimin e IAL-së/IAL-ve merret me vendim të organeve kolegjiale të IAL-së/IAL-ve të interesuara;

...

c) Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin për plotësimin e tij nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 2 (dy) javëve nga marrja e raportit të vlerësimit;

ç) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton aplikantin duke ngarkuar dokumentin me vulë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, institucionin kërkues për vendimin e tij të argumentuar.”.

4. Shkronjat “d” dhe “e”, të pikës 5, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“d) Aplikimi dhe dokumentacioni për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë ngarkohet në portalin unik qeveritar “e-Albania”;

...

e) Në rastin e refuzimit të kërkesës së paraqitur, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë ngarkon dokumentin me vulë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, me anë të të cilit njofton aplikantin për vendimin dhe për shkaqet e marrjes së tij, brenda një afati 90-ditor nga data e aplikimit.”.

5. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Nënndarjet “iii” dhe “v”, të shkronjës “ç”, shfuqizohen;

b) Në shkronjën “e”, fjalët “... jo më vonë se 3 (tre) muaj pas dorëzimit të dosjes ...” zëvendësohen



me “... jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas datës së aplikimit ...”.

6. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Procedurat e aplikimit, sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohen pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, deri në çastin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në çastin e paraqitjes së tyre.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 630, datë 10.10.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 466, DATË 10.6.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE PËR HAPJEN DHE
MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE PRIVATE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, NË TË
CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË
FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET
EDHE NË GJUHË TË HUAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 466, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të shtojcës nr. 1, përmendur në pikën 1, të kreut II, shtohet nënndarja “v”, me këtë përmbajtje:

“v. Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të subjektit aplikues, drejtuesin/t e institucionit arsimor parauniversitar, personelin mësimor, administrativ dhe mbështetës.”.

b) Shkronjat “c”, “dh” dhe “gj”, të shtojcës nr. 2, e përmendur në pikën 2, të kreut II, shfuqizohen.

c) Shkronja “d”, e shtojcës nr. 2, e përmendur në pikën 2, të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Listën e plotë të personelit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ, si dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. Për drejtuesin e institucionit arsimor ngarkohet certifikata e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar (shkollë/kopsht), e lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve ose dokumenti që vërteton pranimin në trajnimin e detyrueshëm përgatitor, si dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit.

Dëshmia e kualifikimit përkatës, ku të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” për drejtuesin e institucionit arsimor parauniversitar, ndërsa për drejtuesin e institucionit parashkollor ngarkohet diploma dhe librezë e punës me të paktën 5 (pesë) vite pune eksperiencë si mësues në arsimin parashkollor.

ii. Për personelin mësimdhënës ngarkohet licenca për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, me përjashtim të mësuesit në arsimin parashkollor për të cilin ngarkohet diploma, si dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit.

Për personelin mësimdhënës në arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë që përjashtohet nga detyrimi për dhënie e provimit të shtetit, ngarkohet diploma dhe librezë e punës që vërteton ushtrimin e profesionit përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për drejtuesin e institucionit arsimor ose personelin mësimdhënës, që ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar të mësuesit



jashtë Republikës së Shqipërisë, ngarkohet dokumenti provues, i lëshuar nga vendi ku është fituar kjo e drejtë, i njohur dhe njësuar nga institucionet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit”.

iii. Për punonjës in administrativ, diploma e arsimit përkatës dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit.

ç) Pas shkronjës “d”, të shtojcës nr. 2, të përmendur në pikën 2, të kreut II, shtohet shkronja “d.1”, me këtë përmbajtje:

“d.1) certifikatën e gjendjes gjyqësore për subjektin aplikues, drejtuesin/t e institucionit arsimor parauniversitar, personelin mësimor, administrativ dhe mbështetës.

Në rastin kur subjekti aplikues është person juridik, certifikatën e gjendjes gjyqësore edhe për administratorin, drejtorin ekzekutiv dhe anëtarët e organeve kolegjiale.”.

d) Në fund të shtojcës nr. 2, të përmendur në pikën 2, të kreut II, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Kopja e lejes higjieno-sanitare dhe e aktit për mbrojtjen nga zjarri për godinën, ku do të ushtrohet veprimtaria e institucionit arsimor parauniversitar privat, të lëshuara nga institucionet përgjegjëse, sigurohen me ndërveprim nga strukturat përkatëse në ministrinë përgjegjëse për arsimin.”.

dh) Në pikën 3, të kreut VI, fjalët “... duke ngarkuar dokumentacionin që përmban të dhënat dhe deklaratimet, sipas shtojcës nr. 4 ...” zëvendësohen me “... duke plotësuar të gjitha të dhënat dhe deklaratimet, sipas rubrikave të shtojcës nr. 4 ...”.

e) Pas pikës 1, të kreut VII, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Procedurat e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik “e-Albania”, zbatohen pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit Parauniversitar, SMIP. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për

arsimin, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit Parauniversitar, SMIP, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 631, datë 10.10.2024

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
VENDIMIN NR. 789, DATË 15.12.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT
DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË
PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË
LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, që ka arritur rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës nr. I, federata shqiptare sportive përkatëse, sportisti apo trajneri i tij aplikon në portalin unik qeveritar “e-Albania”. Në aplikim përcaktohet rezultati përfundimtar në veprimtarinë ndërkombëtare, në të cilin sportisti ka marrë pjesë, shoqëruar me rezultatin përfundimtar të analizave *doping*, si dhe deklarimi i federatës që sportisti nuk ka rekorde pozitive të *doping*-ut të konfirmuar nga Organizata Kombëtare Antidoping. Ministria



përgjegjëse për sportin verifikon përmbushjen e kritereve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për llogari të sportistit dhe të trajnerit të tij.”.

b) Pas pikës 17 shtohet pikat 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet pasi ministria përgjegjëse për sportin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për sportin.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për sportin, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 632, datë 10.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT ‘EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA’, NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 8, të nenit 11, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e

vitet 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e projektit ‘Ekipet sportive në shkolla’, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Financimin, në masën 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të ndarë:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;

b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;

c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024.”;

b) Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Fjalët “... ‘Raiffeisen Bank, sh.a., me numër llogarie 0050249325 ...” hiqen;

ii. Pas fjalëve “... për vitin 2023 ...” shtohen “... si dhe buxheti i miratuar për vitin 2024 ...”;

c) Në pikën 3 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “... brenda muajit shkurt 2024 ...” shtohen “... si dhe brenda muajit shkurt 2025...”;

ii. Fjalët “... shkronjave “a” dhe “b” ...” zëvendësohen me “... shkronjave “a”, “b” dhe “c” ...”;

ç) Në fjalinë e dytë, të pikës 4, viti “2024” zëvendësohet me “2025”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 634, datë 10.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1178, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME TË EVIDENTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, pika 6, dhe 69, pika 9, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 20, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Për kryerjen e procedurave të përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi, Agjencia Shtetërore e Kadastrës mund të veprojë nëpërmjet stafit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në kuadër të një marrëveshjeje të nënshkruar sipas ligjit ose mund të kontrakttojë subjekte private të licencuara në fushat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.”.

2. Aneksi 1 “Akt evidentimi”, ndryshohet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe të gjitha bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA []

AKT EVIDENTIMI

Nr. [], datë []

PËR GJENDJEN NDËRTIMORE NË TERREN, TË NDËRTIMIT PA LEJE

Në zbatim të nenit 17, pika 3 dhe 69, pika 9, të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr... "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje" u krye evidentimi në terren i ndërtimit pa leje i llojit [] Objekt, [] Shtesë, [] Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit N[] prot., datë [] me Numër Unik (INDEX): me adresë _____

Nga evidentimi në terren rezulton se ndërtimi pa leje posedohet nga:

1.

Nr.identifikimi (ID): _____, Nr.cel: _____, Adresa: _____

(Emër, titull, mbiemër)

Ndërtimi pa leje me funksion _____ ka këto të dhëna ndërtimore:

-Sipërfaqja e bazës (njollës) së objektit _____ m²

-Numri i kateve mbi tokë _____ dhe nën tokë _____

-Sipërfaqja e përgjithshme e ndarë sipas funksionit: _____ banim (Sip.m²), aktivitet social-ekonomik _____ (Sip.m²)

-Sipërfaqja e parcelës ndërtimore _____ m² me objekt ndihmës [] pa objekt ndihmës []

*E aplikueshme vetëm për shtesën, objektin me shkelje të lejes së ndërtimit:

-Aplikuesi për legalizim është shoqëri ndërtuese dhe/ose investitor

-Shtesa është kryer për qëllim kalimi pronësie ose qiradhënie

-Funksioni i hapësirave sipas faktit: _____

(Sip.m² për secilin funksion);

-Funksioni i hapësirave sipas projektit të miratuar _____

(Sip.m² për secilin funksion)

Pasuritë kufitare (nr.pasurisë, emër, mbiemër i pronarit të objektit kufitar, lloji i pasurisë psh. objekt, rrugë/kanal etj):

Në veri: _____

Në jug: _____

Në perëndim: _____

Në lindje: _____

Evidentimi në terren u krye nga:

Specialisti i ASHK/Përfaqësuesi i subjektit/ Përfaqësuesi i bashkisë:

1. _____ 2. _____ 3. _____

(emër, mbiemër, firmë)

(emër, mbiemër, firmë)

(emër, mbiemër, firmë)

Konfirmoi për strukturën e Hartografikë të ASHK-Përgjegjësi _____

(emër, mbiemër, firmë)

1-Ky akt plotësohet elektronikisht dhe pas nënshkrimit ruhet në 2 kopje, respektivisht një administrohet në praktikën e legalizimit dhe tjetra ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

2-Kopja e Aktit të evidentimit shoqërohet detyrimisht me skicë tushore.

3-Sipërfaqet që evidentohen në akt do të plotësohen me shifra dhe fjalë.

4-Vërtikimi në terren kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ASHK, punonjësi i Bashkisë ose punonjës të subjektit të kontraktuar.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

